



ZYRA E RREGULATORIT PËR ENERGJI
ENERGY REGULATORY OFFICE
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

RAPORTI VJETOR

2008

Prishtinë
mars 2009

Të nderuar,

Kam nder të veçantë që Kuvendit të Republikës së Kosovës t'ia paraqes Raportin vjetor të punës dhe të aktiviteteve të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) që janë zhvilluar gjatë vitit 2008.

Në Raport janë paraqitur në formë të përmbledhur veprimtaritë kryesore të Zyrës: të Bordit Drejtues, të shërbimeve profesionale, teknike e administrative të saj, duke përfshirë edhe raportet financiare bazë lidhur me realizimin e buxhetit për këtë vit.

Raporti përmban të dhëna thelbësore teknike e ekonomike për ndërmarrjet e energjisë, sidomos për aktivitetet e rregulluara të tyre. Bazuar në analizat gjithëpërfshirëse të aktiviteteve në sektorin e energjisë, sidomos në ato të zhvillimit të infrastrukturës, të tregut dhe të shërbimeve publike, janë paraqitur observime, të dhëna, rezultate e përfundime të rëndësishme për gjendjen ekzistuese dhe për kahet e veprimit për përmirësimin e kësaj gjendjeje.

Sektori i energjisë edhe më tutje përballlet me probleme të shumta infrastrukturore e organizative dhe si i tillë nuk mund t'i përmbushë nevojat e konsumatorëve për energji të mjaftueshme e cilësore. Qeveria e Republikës së Kosovës dhe donatorët kanë akorduar fonde të caktuara për investime në ndërmarrjet e energjisë (KEK dhe KOSTT), që kanë dhënë efekte pozitive, por, për përmirësimet substanciale, nevojiten mjete shumë më të mëdha, të cilat mungojnë.

Për t'i plotësuar nevojat e konsumit për energji është i domosdoshëm ndërtimi i kapaciteteve të reja gjeneruese, transmetuese dhe shpërndarëse. Andaj gjatë këtij viti kanë vazhduar aktivitetet rreth fillimit të ndërtimit të termocentralit "Kosova e Re", bashkë me hapjen e minierës së re të linjtit në Sibovc. Punë e mirë është bërë edhe në joshjen e investitorëve për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese nga burimet e ripërtëritshme të energjisë, sidomos të hidrocentraleve të vogla dhe të gjeneratorëve me energji të erës. Natyrisht, investimet në gjenerim duhet të shoqërohen me investimet përkatëse në transmision e shpërndarje. Këtu vlen të përmendet fillimi i ndërtimit të nënstacionit Peja III 400/110kV dhe rritja e seksionit të përçuesve në disa linja të mbingarkuara.

Në bazë të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë, ZRRE ka një rol aktiv për ta krijuar e adaptuar një kornizë rregullative sa më të përshtatshme për zhvillimin dhe zbatimin me sukses të të gjitha aktiviteteve që i nënshtrohen rregullimit në sektorin e energjisë.

Puna e Bordit të ZRRE-së ka qenë e vështirësuar për arsye se dy anëtarëve të tij u ka kaluar mandati dhe kanë shkuar nga Zyra, ndërsa Bordi ka ngelur vetëm me tre anëtarë dhe, sipas ligjit ekzistues, nuk ka pasur kuorum të mjaftueshëm për të marrë vendime meritore. Me ndryshimin e Ligjit mbi Rregullatorin në qershor është zhbllokuar puna e Bordit, ndërkaq në fund të vitit Kuvendi ka emëruar dy anëtarë të rinj dhe Bordi është kompletuar.

Zyra ka kryer me sukses punët dhe përgjegjësitë e caktuara me ligjet bazë dhe me legjislacionin dytësor të nxjerrë në bazë të tyre. Shumica e legjislacionit dytësor është hartuar e aprovuar, duke siguruar një bazë të mirë ligjore për transformimin e sektorit të energjisë; për hapjen dhe funksionimin e tregut, për rregullimin e ndërmarrjeve energjetike që kanë pozitë monopoli, për dhënien e licencave të operimit për pjesëmarrësit në treg dhe për mbikëqyrjen e tregut dhe të të licencuarve.

Aprovimi i Rregullit për Autorizimin e ndërtimit të kapaciteteve gjeneruese dhe përcaktimi i tarifave nxitëse për prodhimin e energjisë nga hidrocentralet e vogla dhe nga era ka rritur interesimin e investitorëve privatë që të aplikojnë për marrjen e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve nga burimet e ripërtëritshme.

Miratimi i Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike ka krijuar bazë ligjore për vazhdimin e mëtejshëm të rristurimit të ndërmarrjeve energjetike, me qëllim të zhvillimit dhe rritjes së efikasitetit të tyre.

Në këtë drejtim Qeveria e Republikës së Kosovës ka marrë vendim që të fillojë shthurja nga KEK-u e aktiviteteve të furnizimit dhe të rrjetit të shpërndarjes dhe krijimi i një ndërmarrjeje të re, që do të përfshinte këto dy aktivitete, me qëllim të zhvillimit të procedurave për privatizimin e tyre.

Me qëllim të bashkërenditjes së aktiviteteve për zbatimin e strategjisë dhe të politikave në sektorin e energjisë, Zyra ka bashkëpunuar me ministrinë relevante të Qeverisë së Kosovës dhe me komisionet parlamentare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Në planin e bashkëpunimit rajonal e ndërkombëtar, Zyra ka vazhduar t'i kryejë me përpikëri obligimet e saj, në pajtim me Traktatin e Komunitetit të Energjisë të Evropës Juglindore (KEEJL, angl. ECSEE), përmes Bordit Rregullativ të Komunitetit të Energjisë (BRRKE, angl. ECRB) dhe grupeve punuese në kuadër të tij. ZRRE është anëtare e asociuar dhe merr pjesë aktive në veprimtaritë e Asociacionit Rajonal të Rregullatorëve të Energjisë (ARRE, angl. ERRA).

Në tetor të vitit 2008, ZRRE ka nënshkruar Memorandumin e mirëkuptimit për partneritet me Komisionin Komercial të Illionis-it (angl. Illinois Commerce Commission-ICC) të SHBA-ve, i sponsoruar nga USAID-i, me qëllim trajnimit e këmbimi të përvojave.

Veprimtaria e Zyrës financohet nga të ardhurat vetjake që mblidhen nga taksat për shërbimet e kryera për të licencuarit, ndërkaq buxheti vjetor miratohet nga Kuvendi i Kosovës.

Edhe gjatë këtij viti Zyra ka vazhduar të ketë ndihmesë të vlefshme teknike për ngritjen e kapaciteteve të stafit nga donatorët si UE, USAID dhe Banka Botërore.

Zyra ka vazhduar ta bëjë monitorimin e të licencuarve për të konstatuar nëse aktivitetet e tyre kryhen në pajtim me kushtet e licencave të lëshuara, me qëllim të përmirësimit të nivelit të shërbimit e të furnizimit të sigurt të konsumatorëve. Rëndësi e veçantë i është kushtuar fushës së mbrojtjes së konsumatorëve, duke shqyrtuar e zgjidhur ankesat e kontestet e veçanta të tyre, lidhur me kushtet dhe cilësinë e shërbimeve të furnizimit me energji.

Aktivitet tjetër i veçantë ka qenë rishikimi i çmimeve dhe vendosja e tarifave të reja të energjisë elektrike dhe të ngrohjes qendrore, të bazuara në koston e prodhimit e të shërbimit, duke marrë në konsiderim edhe mundësinë e përballimit të tyre nga konsumatorët.

Unë jam krenar me kolegët, bashkëpunëtorët dhe stafin e ZRRE-së dhe përgëzoj ata për njohuritë dhe përkushtimin e tyre për kryerjen me sukses të punëve dhe të detyrave për t'u shërbyer konsumatorëve të energjisë dhe për të mbështetur infrastrukturën dhe zhvillimin e tregut që do të ndihmojnë për të përmbushur sfidat me të cilat përballet sektori i energjisë në Kosovë .

Me respekt,



Dr. Ali Hamiti

Kryesues i Bordit

1. NJOHURI TË PËRGJITHSHME PËR ZYRËN E RREGULLATORIT PËR ENERGJI TË KOSOVËS .	8
1.1 BAZA LIGJORE DHE MANDATI I ZYRËS SË RREGULLATORIT PËR ENERGJI	8
1.2 ORGANIZIMI I ZYRËS SË RREGULLATORIT PËR ENERGJI DHE BURIMET NJERËZORE	8
1.2.1 BORDI I ZYRËS SË RREGULLATORIT PËR ENERGJI.....	8
1.2.2 DEPARTAMENTET E ZYRËS SË RREGULLATORIT PËR ENERGJI	9
1.2.3 STAFI I ZYRËS SË RREGULLATORIT PËR ENERGJI	9
1.2.4 SKEMA ORGANIZATIVE E ZYRËS SË RREGULLATORIT PËR ENERGJI	10
1.3 ASISTENCA TEKNIKE, TRAJNIMET DHE AKTIVITETET TJERA TË ZYRËS SË RREGULLATORIT PËR ENERGJI	10
1.4 RAPORTI VJETOR FINANCIAR I ZYRËS SË RREGULLATORIT PËR ENERGJI - 2008.....	13
2. ZHVILLIMET RREGULLATIVE	16
2.1 KOMPLETIMI I KORNIZËS LIGJORE RREGULLATIVE	16
2.2 RREGULLAT E MIRATUARA.....	16
2.3 DOKUMENTET E DRAFTUARA	17
2.4 NDRYSHIMI DHE PLOTËSIMI I RREGULLAVE EKZISTUESE	17
2.5 AKTIVITETET RRETH LICENCIMIT DHE MONITORIMIT	17
3. SEKTORI I ENERGJISË ELEKTRIKE.....	20
3.1 KAPACITETET PRODHUESE DHE TRANSMETUESE.....	20
3.2 PRODHIMI DHE SHPENZIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE	22
3.3 TREGU I ENERGJISË ELEKTRIKE.....	28
3.4 IMPORTI DHE EKSPORTI I ENERGJISË ELEKTRIKE	30
3.5 HUMBJET NË SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE	33
3.6 AKTIVITETET E ZRRE-SË RRETH NDËRTIMIT TË KAPACITETEVE TË REJA GJENERUESE.....	37
3.7 TARIFAT E ENERGJISË ELEKTRIKE	38
3.7.1 NGARKESAT E RREGULLUARA TË TRANSMISIONIT DHE TË SHPËRNDARJES	38
3.7.2 TARIFA NXITËSE (FEED-IN) PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA BURIMET E RIPËRTËRITSHME	41

4. SEKTORI I NGROHJES QENDRORE.....	42
4.1 PËRMBLEDHJE E ZHVILLIMEVE NË SEKTORIN E NGROHJES QENDRORE	42
4.2 PERFORMANSA E KOMPANIVE TË NGROHJES QENDRORE	42
4.3 ÇËSHTJET LIDHUR ME KONSUMATORËT	44
4.4 SHQYRTIMI I ÇMIMEVE TË NGROHJES QENDRORE PËR SEZONIN E NGROHJES 2007/2008.....	45
5. MBROJTJA E KONSUMATORËVE.....	48
5.1 HYRJE – BAZA LIGJORE	48
5.2 ANKESAT DHE AKTIVITETET NË ZGJIDHJEN E KONTESTEVE.....	48
6. PERSPEKTIVA E SEKTORIT TË GAZIT NATYROR NË KOSOVË	50
7. BASHKËPUNIMI I ZRRE-së ME INSTIUCIONET E TJERA DHE AKTIVITETI NDËRKOMBËTAR	52

LISTA E SHKURTESAVE

AER-i	Agjencia Evropiane për Rindërtim
BKK	Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
CAO	Coordinated Auction Office
DLL	Departamenti për Çështje Ligjore dhe Licencim
DMK	Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve
ECLO	Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Europian
ECRB	Energy Community Regulatory Board
EFT	Energy Financing Team (Ekipi për Financimin e Energjisë)
EJL	Evropa Juglindore
EPS	Ndërmarrja Energjetike e Serbisë
GWh	Giga Watt orë
HC	Hydrocentral
KE	Komuniteti i Energjisë
KEEJL	Komuniteti i Energjisë në Evropën Juglindore
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KESH	Korporata Energjetike e Shqipërisë
KNQ	Kompania e Ngrohjes Qendrore
KNQ	Kompani për Ngrohje Qendrore
KOSTT	Operatori i Sistemit të Transmisionit (Bartjes) dhe Tregut në Kosovë
kV	Kilovolt
kW	Kilovat
kWh	Kilovat orë
MEM	Ministria e Energjisë dhe Minierave
MW	Megavat
MWh	Megavat orë
NA	Nuk Aplikohet
NARUC	National Association of Regulatory Utility Commissioners
NERA	NERA Economic Consulting - Kompani ndërkombëtare ekonomike konsulente
OS	Operator Sistemi
OSSH	Operator i Sistemit të Shpërndarjes
OST	Operatori i Sistemit të Transmisionit
OSTEJL	Operatori i Sistemit të Transmisionit për Evropën Juglindore
OT	Operator Tregu

RCEPR	Qendra Rajonale për Hulumtim të Politikave Energjetike
RTK	Radio Televizioni i Kosovës
SEE-CAO	Coordinated Auction Office in South East Europe
SHA	Shoqëri Aksionare
SHSSH	Shfrytëzim i Sistemit të Shpërndarjes
SHST	Shfrytëzimi i Sistemit të Transmisionit
TC	Termocentral
TKEEJL	Traktati i Energjisë i Evropës Juglindore
UNMIK	Misioni i Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim Ndërkombëtar
ZRRE	Zyra e Rregullatorit për Energji

1. NJOHURI TË PËRGJITHSHME PËR ZYRËN E RREGULLATORIT PËR ENERGJI TË KOSOVËS

1.1 BAZA LIGJORE DHE MANDATI I ZYRËS SË RREGULLATORIT PËR ENERGJI

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) është themeluar me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë Nr. 2004/9, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 29 prill 2004 dhe shpallur nga Përfaqësuesi Special i Kombeve të Bashkuara (PSSP) me Rregulloren Nr. 2004/21 të datës 30 qershor 2004. Ky ligj është ndryshuar me Ligjin Nr.03/L-080 për Ndryshimin e Ligjit të Kuvendit të Kosovës 2004/9 mbi Rregullatorin e Energjisë (Ligjet e Pakos së Ahtisarit), i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 13 qershor 2008.

Ligji i cekur më lart, në nenin 15, përcakton përgjegjësitë e Zyrës së Rregullatorit për Energji, të cilat ushtrohen përmes: ***lëshimit dhe monitorimit të licencave për aktivitetet e energjisë, dhënies së lejeve për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, të rrjeteve të gazit, të linjave direkte elektroenergjetike dhe të linjave gypore direkte, aprovimit të metodologjisë së çmimeve dhe tarifave për aktivitetet që nuk i nënshtrohen tregut, nxjerrjes së legjislacionit dytësor që rregullon sektorin e energjisë, monitorimit të ndarjes efektive dhe zhvillimit të konkurrencës në sektorin e energjisë, si dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në sektorin e energjisë.***

Duhet theksuar se Ligji për Rregullatorin e Energjisë nr. 2004/9, i ndryshuar me Ligjin Nr.03/L-080 për Ndryshimin e Ligjit të Kuvendit të Kosovës 2004/9 mbi Rregullatorin e Energjisë, është në përputhje të plotë me nenin 119, paragrafi 5 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i cili përcakton: “Republika e Kosovës do të themelojë organe të pavarura për rregullimin e tregut, atëherë kur vetë tregu nuk mundet në masë të mjaftueshme të mbrojë interesin publik”, dhe me dispozitat e nenit 142, paragrafi 1 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, që përcakton: “Agjencitë e pavarura të Republikës së Kosovës janë institucione të krijuara nga Kuvendi, në bazë të ligjeve përkatëse, të cilat rregullojnë themelimin, funksionimin dhe kompetencat e tyre. Agjencitë e pavarura funksionet e tyre i kryejnë në mënyrë të pavarur nga çdo organ ose autoritet tjetër në Republikën e Kosovës”.

1.2 ORGANIZIMI I ZYRËS SË RREGULLATORIT PËR ENERGJI DHE BURIMET NJERËZORE

1.2.1 BORDI I ZYRËS SË RREGULLATORIT PËR ENERGJI

ZRRE-ja është e organizuar në pajtim me Kreun 2 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe drejtohet nga pesë anëtarë të Bordit.

Anëtarët e Bordit përmbushin detyrat dhe obligimet në përputhje me përgjegjësitë që parashihen me Ligjin mbi Rregullatorin e Energjisë.

Gjatë tërë vitit 2007 Bordi i ZRRE-së ka pasur 4 anëtarë. Me gjithë kërkesën e bërë nga Kryetari i Bordit të ZRRE-së, Kuvendit të Kosovës, anëtari i pestë nuk është emëruar. Në shkurt 2008 i ka skaduar mandati edhe një anëtar i Bordit, i cili ishte emëruar nga PSSP-ja. Për një periudhë të caktuar, Bordi i ZRRE-së ka mbetur jofunksional për shkak të mungesës së kuorumit. Në qershor 2008, Kuvendi i Kosovës ka amendamentuar Ligjin 2004/09 për Rregullatorin e Energjisë, me Ligjin Nr. 03/L-080. Ky amendamentim lejoi Bordin e ZRRE-së të funksionalizohej dhe të nxirrte vendime me shumicën e anëtarëve të pranishëm.

Me propozim të Qeverisë së Kosovës, në dhjetor 2008, Kuvendi i Kosovës ka emëruar dy anëtarët tjerë të Bordit dhe me këtë Bordi i ZRRE-së do të kompletohet.

Gjatë vitit 2008, Bordi i ZRRE-së ka mbajtur tetë takime dhe ka nxjerrë 81 vendime.

1.2.2 DEPARTAMENTET E ZYRËS SË RREGULLATORIT PËR ENERGJI

Departamenti Ligjor dhe i Licencimit

Departamenti Ligjor dhe i Licencimit (DLL) merret me mbështetje ligjore sipas ligjeve në fuqi të Republikës së Kosovës, për të gjitha çështjet në sektorin e energjisë, si dhe me zhvillimin e të gjitha formave të licencave, aplikacioneve të ndryshme dhe procedurave për licencim dhe për autorizim. Departamenti Ligjor dhe i Licencimit është përgjegjës edhe për mbikëqyrjen/monitorimin e aktiviteteve të licencuara.

Departamenti për Mbrojtje të Konsumatorëve

Departamenti për Mbrojtje të Konsumatorëve (DMK) merret me ankesat e konsumatorëve dhe me kontestet ndërmjet organizatave energjetike. Gjatë kryerjes së detyrave dhe përgjegjësi, ky departament bashkëpunon me të gjitha organizatat të cilat në mënyrë legjitime i përfaqësojnë konsumatorët.

Departamenti i Tarifave dhe Çmimeve

Departamenti i Tarifave dhe Çmimeve (DÇT) merret me tarifat e energjisë në përgjithësi, analizon dhe përcakton për vendimmarrje sistemet tarifore, strukturat dhe nivelet tarifore të propozuara nga organizatat energjetike. Ky element është përgjegjës për implementimin e elementeve të reja të konkurrencës në treg.

Departamenti i Furnizimit me Energji dhe Strukturë të Tregut

Departamenti i Furnizimit me Energji dhe Strukturë të Tregut (DFEST) mbledh dhe analizon informatat lidhur me kapacitetin dhe bilancin e energjisë. Analizon ndikimin e faktorëve të ndryshëm si: inflacioni, çmimi i lëndës djegëse, zhvlerësimi etj., në çmimin e tregut dhe në çmimin e rregulluar të konsumatorit fundor. Ky departament bën edhe monitorimin e çmimeve të tregut.

Grupi teknik këshillëdhënës

Grupi teknik këshillëdhënës i ofron këshilla teknike Bordit të ZRRE-së dhe departamenteve, për t'i përmbushur funksionet e tyre në pajtueshmëri me ligjin.

Zyra administrative


Zyra administrative ofron përkrahje administrative për të gjitha departamentet e tjera të ZRRE-së, po ashtu dhe të Bordit, për një funksionim normal të Zyrës.

1.2.3 STAFI I ZYRËS SË RREGULLATORIT PËR ENERGJI

Në fillim të vitit 2008, ZRRE-ja në përbërjen e vet ka pasur 20 anëtarë. Gjatë muajve të parë të vitit 2008, ZRRE ia arriti t'i plotësojë vendet e zbrazëta të Ekspertit për Ngrohje Qendrore dhe Gaz, Kryesuesit të Departamentit për Mbrojtje të Konsumatorëve, dhe Analistit për Kosto dhe Çmime. Kjo ka ndikuar në funksionimin më të mirë dhe më efikas të ZRRE-së.

1.2.4 SKEMA ORGANIZATIVE E ZYRËS SË RREGULLATORIT PËR ENERGJI

Fig. 2.1 Skema organizative e Zyrës së Rregullatorit për Energji



1.3 ASISTENCA TEKNIKE, TRAJNIMET, INFORMIMI I PUBLIKUT DHE AKTIVITETET TJERA TË ZYRËS SË RREGULLATORIT PËR ENERGJI

ASISTENCA TEKNIKE

Projekti i asistencës teknike “Sigurimi i ndihmës për ngritje të kapaciteteve të ZRRE-së”, i financuar nga AER dhe i implementuar nga kompania konsulente ndërkombëtare “NERA Economic Consulting”, ka vazhduar deri në gusht 2008. Qëllimi kryesor i projektit ka qenë që, në mënyrë efikase, të implementojë kornizën rregullative dhe të sigurojë kushte transparente dhe jodiskriminuese të funksionimit të tregut të energjisë në Kosovë, në pajtueshmëri të plotë me ligjet e energjisë në Kosovë dhe me kërkesat që dalin nga zbatimi i Traktatit të Komunitetit të Energjisë në Evropën Juglindore, nënshkrues i të cilit është edhe Kosova.

Projekti e ka fuqizuar ZRRE-në në shumë fusha që kanë rëndësi esenciale për operim dhe monitorim të tregut:

- shqyrtimi dhe miratimi i kodeve të ndryshme teknike dhe operacionale;
- implementimi i shqyrtimit të çmimeve për aktivitetet e ndryshme të energjisë elektrike dhe ngrohjes qendrore, bazuar në metodologjinë e tarifave;
- dizajni, analiza dhe vlerësimi i kërkesave licencuese, duke pasur parasysh kërkesat për lëshim të licencave;

- dizajni dhe përgatitja e specifikimeve për sistemet e teknologjisë informative, të nevojshme për punën e ZRRE-së;
- njohja me procedurat për menaxhim kualitativ të punës në ZRRE;
- trajnimi i duhur i stafit të ZRRE-së në fushat e lartpërmendura.

Në kuadër të këtij projekti, në maj 2008, shtatë anëtarë të stafit të ZRRE-së, duke përfshirë edhe një anëtar të Bordit, kanë bërë një vizitë studimore në “RAE” - Agjencia Rregullative për Energji Elektrike dhe Gaz - Athinë, Greqi.

Projekti i asistencës teknike “Themelimi i kornizës rregullative për burime të ripërtëritshme në Kosovë”, i financuar nga Banka Botërore, është akoma në proces të përgatitjes së tij.

Objektiv primar i këtij projekti është të mbështesë ZRRE-në që të zhvillojë komponentët kryesorë të kornizës rregullative për burimet e ripërtëritshme, të cilat bien në juridiksionin e saj dhe të shtojë kapacitetin e ZRRE-së për t’i përmbushur detyrat e tilla rregullative.

Synimi është që ekipi i konsulentëve të punojë me stafin e ZRRE-së dhe menaxhmentin e lartë për të zhvilluar rregullat, politikat dhe procesin e vendimmarrjes. Pritet që ky projekt të implementohet brenda një viti.

Projekti është akoma në procesin e selektimit të kompanisë konsulente.

Gjithashtu, lidhur me çështjet rregullative në sektorin e energjisë në përgjithësi, ZRRE mbështetet nga një konsulent i USAID-it.

INFORMIMI I PUBLIKUT

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE), gjatë punës së saj, i ka kushtuar një rëndësi të veçantë transparencës dhe informimit të publikut për punën e saj.

I gjithë legjislacioni sekondar i nxjerrë nga ZRRE-ja ka kaluar përmes një procesi tërësisht të hapur për publikun, ku janë përfshirë edhe dëgjimet publike, përmes të cilave janë marrë komentet e publikut. Përveç kësaj, edhe procesi i vendimmarrjes është zhvilluar në seanca të hapura, gjatë të cilave publikut i është mundësuar të japë komente deri në momentin e fundit, kur dhe është marrë vendimi për aprovimin e dokumenteve të ndryshme.

Në përputhje me Statutin e ZRRE-së, të gjitha takimet e Bordit paralajmërohen në ueb-faqen zyrtare të ZRRE-së pesë ditë para datës së takimit, ndërsa pas takimit në ueb-faqe publikohen të gjitha vendimet e marra nga Bordi.

Përveç raportit vjetor dhe dokumenteve të tjera, ZRRE-ja publikon raportet mujore, në të cilat përfshihen të gjitha aktivitetet që zhvillojnë departamentet e saj.

Në rastet kur në Bord janë diskutuar dhe janë marrë vendime për çështjet që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me interesin e publikut, siç është për shembull çështja e tarifave të energjisë, në mënyrë që informimi të jetë sa më gjithëpërfshirës, përveç publikimit në ueb-faqe dhe informimit të palëve të interesit, është ftuar edhe publiku i gjerë për të dhënë komente, si dhe është tërhequr vëmendja e mediave, përmes komunikatave dhe konferencave për shtyp.

Përveç që përcjell çdo ditë informatat e mediave për sektorin e energjisë, ZRRE gjithashtu mban edhe një komunikim të përditshëm me gazetarët e të gjitha mediave, duke dhënë sqarime për të gjitha çështjet e rregullimit të sektorit të energjisë, që ata i shtrojnë për diskutim. Duke pasur si synim një informim të drejtë, ekspertë të ndryshëm të ZRRE-së kanë

treguar gjithmonë gatishmëri për të marrë pjesë në intervista, emisione dhe takime të ndryshme që janë kërkuar nga mediat në Kosovë.

TRAJNIMET

Katër anëtarë të stafit të ZRRE-së kanë ndjekur trajnimin njëvjeçar “Programi i Zhvillimit Profesional”, financuar nga USAID-i dhe implementuar nga Bearing Point. Qëllimi i trajnimit ishte të fuqizojë stafin në fushën menaxheriale duke përmirësuar cilësinë e punës dhe duke shtuar efikasitetin dhe produktivitetin në punë.

Në janar 2008, pjesëmarrja në trajnimin me temën “Tregu i energjisë”, organizuar nga Asociacioni Rajonal i Rregullatorëve të Energjisë, Agjencia Amerikane për Zhvillim dhe Qendra Rajonale për Hulumtim të Politikave Energjetike (RCEPR). Qëllimi i trajnimit ishte “Rregullimi deri te Liberalizimi i Tregut”, struktura e tregut, intervenimi i shteteve (Rregullim - Liberalizim), modelet alternative të tregut të energjisë: principet bazë për tregun e energjisë, integrimet e tregut të energjisë, çmimi me shumicë i energjisë, zhvillimi i tregut rajonal, rruga deri te liberalizimi i tregut të energjisë dhe këmbimi i energjisë në Evropë.

Në mars 2008, pjesëmarrja në kursin e avancuar FSR mbi Tregun e Energjisë Elektrike, të organizuar në Firencë, Itali. Qëllimi i këtij kursi ka qenë analiza e funksionimit dhe rregullimit të tregut të energjisë në specifikacione të ndryshme si tregu me shumicë: kontratat bilaterale, tregu ditor, bilanci; po ashtu edhe tregu me pakicë: tarifat, mbrojtja e konsumatorëve, kualiteti. Një nga qëllimet e kursit ishte edhe ekzaminimi i qasjes së mbikëqyrjes së tregut dhe zbutja e fuqisë së tregut, si dhe shqyrtimi i mundësive dhe pengesave që dalin në tregun e energjisë nga rrjeta si humbjet, kongjestioni dhe nevoja për investime;

Në nëntor 2008, pjesëmarrja në programin Energy Training Programme, i organizuar në Lubjanë, Slloveni. Qëllimi i programit ka qenë liberalizimi dhe dizajnimi i Tregut, qeveritë dhe rregullatorët, certifikatat e origjinës, energjia e ripërtëritshme.

1.4 RAPORTI VJETOR FINANCIAR I ZYRËS SË RREGULLATORIT PËR ENERGJI - 2008

Zyra e Rregullatorit për Energji financohet nga të hyrat vetjake, në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, kreu 4, përkatësisht nga taksat që mblidhen nga operatorët e licencuar.

Të hyrat

Të gjitha të hyrat e mbledhura të Zyrës së Rregullatorit për Energji janë depozituar në pajtim me nenin 20 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe nenit 64 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, në llogarinë zyrtare bankare të krijuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit.

Për vitin 2008, Zyra e Rregullatorit për Energji ka planifikuar të realizojë të hyra në shumë prej 1,135,659 euro, ndërsa shuma e të hyrave që ZRRE ka arkëtuar gjatë këtij viti është 1,145,130.33 euro, gjegjësisht 9,471.33 euro më shumë se shuma e planifikuar.

Nga të hyrat e pashpenzuara të vitit 2007, ZRRE-së në vitin 2008 i janë bartur 150,236.07 euro.

Krahasuar me vitin 2007, kur të hyrat e arkëtuara të ZRRE-së kanë qenë 944,104 euro, këtë vit ZRRE ka arkëtuar 201,026.33 euro më shumë, gjegjësisht 21.29%.

Tab.1.1 Të hyrat

Përs hkrimi	Të hyrat
Të hyrat vetjake 2008	1,145,130.33
Të hyrat vetjake të bartura nga viti 2007	150,236.07
Gjithsej të hyrat	1,295,366.40

Buxheti

Kuvendi i Kosovës me vendimin V-013 të datës 15.02.2008, miratoi buxhetin e Zyrës së Rregullatorit për Energji në shumë prej 1,062,545 euro, i ndarë në kategoritë kryesore ekonomike si në vijim:

Përshkrimi	Shuma
Paga dhe mëditje	401,045.00
Mallra dhe shërbime	604,000.00
Shpenzime komunale	17,500.00
Shpenzime kapitale	40,000.00

Me proces të rishikimit, buxheti i Zyrës së Rregullatorit për Energji nuk ka pësuar ndryshime, po ashtu nuk ka pasur transfere të mjeteve nga një kategori në kategorinë tjetër ekonomike.

Nga të hyrat e pashpenzuara të vitit 2007, në shumë prej 691,314.00 euro, 541,077.93 euro kanë mbetur të hyra për Buxhetin e Republikës së Kosovës, ndërsa 150,236.07 euro janë bartur në buxhetin e ZRRE- së për vitin 2008 në këto kategori ekonomike:

Përshkrimi	Shuma
Paga dhe mëditje	56,324.32
Mallra dhe shërbime	80,154.13
Shpenzime komunale	13,018.62
Shpenzime kapitale	739.00

Nga kjo shihet se buxheti i Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin 2008 ka qenë 1,212,781.07 euro.

Shpenzimet buxhetore

Për financimin e aktiviteteve të zhvilluara në vitin 2008, ZRRE ka shpenzuar 435,848.62 euro, prej tyre 372,484.55 euro nga të hyrat vetjake të vitit 2008, ndërsa 63,364.07 euro nga të hyrat e bartura nga viti 2007.

Sipas klasifikimit ekonomik, shpenzimet e ZRRE-së janë si vijon:

Përshkrimi	Shuma
Paga dhe mëditje	45,309.96
Mallra dhe shërbime	183,407.68
Shpenzime komunale	7,130.98
Totali	435,848.62

Në raport me buxhetin e aprovuar dhe atë të bartur nga viti paraprak, shkalla e shpenzimeve buxhetore e shprehur në përqindje është 35.94%. Kjo shkallë relativisht e ulët e realizimit të buxhetit ka ndodhur kryesisht për shkak se:

- Mosemërimi i dy anëtarëve të bordit gjatë tërë vitit 2008 ka ndikuar drejtpërdrejt në shkallën e realizimit të buxhetit për paga dhe mëditje;
- Buxheti i planifikuar për shërbime të konsulencës në shumë prej 305,000.00 euro nuk është shpenzuar për arsye se shpenzimet për këtë destinim janë mbuluar nga donacionet që ZRRE ka përfituar nga Banka Botërore (WB) në vlerë prej 176,648.00 dollarë dhe Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Europian (ECLC) në vlerë prej 985,600.00 euro;
- Pjesa dërmuese e shpenzimeve për udhëtime zyrtare jashtë vendit janë mbuluar nga Sekretariati i Komunitetit për Energji me seli në Vjenë;
- Buxheti i planifikuar për shpenzime kapitale (40,000 euro) nuk është shpenzuar për shkak të dështimit të aktivitetit të prokurimit.

Sipas kategorive ekonomike, shkalla e shpenzimeve buxhetore është e paraqitur në tabelën 1.2.

Tab.1.2 Shpenzimet buxhetore të shprehura në përqindje

Përshkrimi	Buxheti	Shpenzimet	Shpenzimet në %
Paga dhe mëditje	457,369.32	245,309.96	53.63%
Mallra dhe shërbime	684,154.13	183,407.68	26.80%
Shpenzime komunale	30,518.62	7,130.98	23.36%
Shpenzime kapitale	40,739.00	0.00	0.00%
Totali	1,212,781.07	435,848.62	35.94%

Tabelat në vazhdim pasqyrojnë shpenzimet e ZRRE-së sipas nënkategorive kryesore ekonomike.

Tab.1.3 Pagat dhe mëditjet

PAGAT DHE MËDITJET	SHUMA
Pagat neto	193,221.86
Tatimi i ndalur në të ardhura personale	28,725.24
Kontributet pensionale të punëdhënës it	11,681.43
Kontributet pensionale të të punësuarve	11,681.43
Gjithësej pagat dhe mëditjet	245,309.96

Tab.1.4 Mallrat dhe shërbimet

MALLRAT DHE SHËRBIMET	SHUMA
Shpenzimet e udhëtimit brenda vendit	3,255.22
Shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit	9,632.54
Internet	2,669.94
Shpenzimet tjera telefonike (tel.roaming dhe kartela mbushëse)	10,673.73
Shpenzimet postare	132.10
Shërbimet arsimore dhe trajnuese	2,803.40
Shërbimet e ndryshme intel. dhe këshillëdhënëse	100.00
Shërbime shtypjeje	4,843.00
Shërbime të tjera kontraktuese	12,586.24
Mirëmbajtja e softuerit	2,745.00
Mobilje	830.00
Makina fotokopjuese	4,986.40
Pajisje të tjera	980.00
Kompjuter	3,582.00
Furnizime për zyrë	9,795.97
Furnizim me ushqim dhe pije	4,070.98
Akomodimi	3,066.54
Naftë për ngrohje qendrore	12,010.01
Derivate për gjenerator	3,677.83
Karburant për vetura	2,368.82
Regjistrimi dhe sigurimi i automjeteve	896.21
Sigurimi i ndërtesave	10,781.40
Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	3,059.53
Mirëmbajtja e ndërtesave	8,640.00
Mirëmbajtja e teknologjisë informative	2,964.90
Qiraja për ndërtesa	50,198.00
Reklamat dhe konkurset	6,651.00
Botimet e publikimeve	276.00
Shpenzimet e reprezentacionit	5,130.92
Gjithsej mallra dhe shërbime	183,407.68

Tab.1.5 Shpenzimet komunale

SHPENZIMET KOMUNALE	SHUMA
Rryma	4,429.46
Uji	330.70
Shpenzimet e telefonit fiks	2,370.82
Gjithsej shpenzime komunale	7,130.98

Duke u bazuar në të dhënat e lartshënuara arrijmë në përfundim se të hyrat që ZRRE ka arkëtuar në vitin 2008 (1,295,366.40 euro), janë shumë më të larta sesa shpenzimet buxhetore (435,848.62 euro). Ndryshimi mes të hyrave dhe shpenzimeve në shumë prej 859,517.78 euro, paraqet fondet suficitare që ZRRE ka mbledhur gjatë këtij viti dhe të cilat, konform nenit 20 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, duhet të barten në vitin 2009.

Tab.1.6 Të hyrat vetjake të bartura

Të hyrat e bartura nga viti 2007	150,236.07
Të hyrat e pranuar gjatë vitit 2008	1,145,130.33
Gjithsej të hyrat 2008	1,295,366.40
Shpenzimet për paga dhe mëditje	(245,309.96)
Shpenzimet për mallra dhe shërbime	(183,407.68)
Shpenzimet komunale	(7,130.98)
Gjithsej shpenzimet 2008	(435,848.62)
Të hyrat vetjake të bartura	859,517.78

2. ZHVILLIMET RREGULLATIVE

2.1 KOMPLETIMI I KORNIZËS LIGJORE RREGULLATIVE

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) gjatë vitit 2008 ka zhvilluar një sërë aktivitete në drejtim të kompletimit të kornizës ligjore rregullative, duke përfshirë dhënien e komenteve në propozimet për ndryshime të ligjeve primare të energjisë, në zhvillimin dhe miratimin e legjislacionit dytësor dhe amendamentimin e legjislacionit dytësor ekzistues. Gjatë përgatitjes së këtyre rregullave, DLL është përkujdesur që ato të jenë në pajtim me Direktivat dhe Rregulloret e BE-së, si dhe ligjet e zbatueshme në Kosovë.

Gjatë kësaj periudhe gjithashtu janë paraqitur kërkesa të ndryshme që kanë të bëjnë me licencimin e ndërmarrjeve të energjisë, si dhe mbikëqyrjen dhe monitorimin e aktiviteteve të licencuara, ku ZRRE ka qenë e gatshme të monitorojë pajtueshmëritë me kushtet e licencave dhe me vendimet përkatëse të Rregullatorit.

2.2 RREGULLAT E MIRATUARA

Ndër aktivitetet e rëndësishme të ZRRE-së, të cilat kanë të bëjnë me zhvillimin dhe miratimin e disa rregullave, ndryshimin e disa rregullave ekzistuese si dhe licencimin e ndërmarrjeve të energjisë, janë si në vijim:

I. Rregulli për procedurën e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, rrjetave të gazit, linjave direkte elektroenergjetike dhe linjave gypore direkte (Rregulli i Autorizimit)

Rregulli përcakton kriteret dhe procedurat për dhënien e autorizimit për ndërtimin e stabilimenteve të reja gjeneruese, rrjetave të gazit, linjave direkte elektroenergjetike dhe linjave gypore direkte, në mënyrë që të krijohen kushte për shfrytëzim më eficient dhe me kosto efektive të energjisë, dhe me kujdes të duhur ndaj shëndetit njerëzor, sigurisë dhe mjedisit.

Vlen të theksohet se gjatë këtij viti ZRRE ka mbajtur shumë takime me investitorë potencialë të interesuar për investime në burime të ripërtëritshme të energjisë dhe të njëjtit kanë kërkuar shpjegime në ZRRE për ndërtimin e kapaciteteve të tilla gjeneruese. ZRRE ka udhëzuar palët e interesuara se investimet e tilla do të mund të realizohen pas aprovimit të Rregullit për Autorizim dhe miratimit të Tarifave nxitëse "Feed-in" për burimet e ripërtëritshme të energjisë.

II. Rregulli mbi Masat Administrative dhe Gjobat

Ky rregull është nxjerrë në përputhje me mandatin e ZRRE-së të dhënë në Nenin 57 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë. Rregulli është finalizuar dhe miratuar gjatë këtij viti dhe përcakton masat administrative dhe gjobat që Zyra mund t'i ndërmarrë ndaj të licencuarve në rastet kur veprimet e të licencuarve janë në kundërshtim me kushtet e licencës, në raste të moszbatimit të çmimeve dhe tarifave në fuqi apo moszbatimit të rregullave, akteve, vendimeve dhe udhëzimeve të nxjerra nga ZRRE.

III. Rregulli mbi informatat konfidenciale

Rregulli është zhvilluar dhe miratuar nga ZRRE dhe përmban procedurat lidhur me përcaktimin se kur një dokument i dorëzuar në ZRRE përmban informata konfidenciale dhe konsiderohet material i veçantë, si dhe procedurat për qasjen në informata të tilla konfidenciale.

2.3 DOKUMENTET E DRAFTUARA

Këto dy dokumente në vijim janë draftuar, por ende nuk janë finalizuar. Derisa dokumenti i parë (Doracaku i Punës) duhet të kalojë nëpër procedurën e miratimit nga Bordi, dokumenti i dytë (Doracaku i Raportimit) konsiderohet si një udhëzues për të licencuarit dhe nuk kërkohet miratimi i tij.

I. Doracaku i Punës

Doracaku i Punës është draftuar në fund të vitit 2007. Është dokument masiv (146 faqe), që përcakton procedurat e brendshme dhe ndihmon dhe udhëzon stafin lidhur me përgjegjësitë që kanë brenda zyrës dhe ndaj publikut në përgjithësi. Gjithashtu, në të përshkruhet organizimi i brendshëm i ZRRE-së dhe rolet, përgjegjësitë dhe procedurat që mbulojnë aktivitetet si brenda ashtu edhe jashtë ZRRE-së. Ky dokument, për shkak të specifikave dhe rëndësisë së cekur më lart, nuk është përfunduar deri më tani dhe planifikohet të finalizohet dhe miratohet gjatë vitit 2009.

II. Doracaku i Raportimit

Doracaku i Raportimit është një udhëzues, roli i të cilit është që t'u ndihmojë të licencuarve se si të organizohen më mirë për t'i përmbushur obligimet që dalin nga licencat. Ky dokument gjithashtu përcakton mënyrën dhe afatet e raportimit (tremujore dhe vjetore) për të licencuarit, lidhur me plotësimin e obligimeve që dalin nga kushtet e licencave.

2.4 NDRYSHIMI DHE PLOTËSIMI I RREGULLAVE EKZISTUESE

Për shkak të paraqitjes së nevojës së avancimit dhe lehtësimit në zbatimin/implementimin e rregullave dytësore ekzistuese, ZRRE ka nisur iniciativën për ndryshimin dhe plotësimin e këtyre rregullave si në vijim. Këto rregulla kanë kaluar nëpër të gjitha fazat e pjesëmarrjes së publikut (tryeza punuese, prezantimi publik) dhe në to janë përfshirë edhe shumë komente të palëve të interesuara, ndërsa aprovimi i tyre pritet të bëhet gjatë vitit 2009.

Rregulli mbi kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji.

Rregulli mbi shkyçjen dhe rikyçjen e konsumatorëve në sektorin e energjisë në Kosovë, dhe

Rregulli mbi procedurën e zgjidhjes së kontesteve në sektorin e energjisë.

Ndër aktivitetet me rëndësi që kjo Zyrë ka zhvilluar gjatë vitit 2008 janë edhe aprovimi i një sërë kodesh teknike, rregullash dhe dokumentesh, të cilat janë përpiluar nga të licencuarit, janë plotësuar, komentuar dhe aprovuar nga Zyra. Ndër këto dokumente do të theksojmë vetëm disa: Kodi i Rrjetit, Kodi i Matjes dhe i Distribuimit, Kodi i Pajisjeve Elektrike, Standardet e Sigurisë dhe Planifikimit të Sistemit të Transmisionit, Standardet e Sigurisë së Operimit të Sistemit të Transmisionit, Kodi i qasjes në tokë dhe ndërtesa, Indikatorët Teknikë të Performansës të Operatorit të Sistemit të Transmisionit, Metodologjia e Tarifave për Kyçje në Rrjetin e Transmisionit të KOSTT SHA etj.

2.5 AKTIVITETET RRETH LICENCIMIT DHE MONITORIMIT

Në bazë të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, ZRRE-ja ka autoritet të lëshojë, të modifikojë dhe të tërheqë licencat. Aktivitetet e zhvilluara lidhur me licencimin e ndërmarrjeve të energjisë gjatë vitit 2008 janë si më poshtë:

LICENCIMI

Në këtë vit disa kompani të huaja kanë aplikuar për licencë për furnizim/tregti me energji elektrike. Aplikacionet i janë nënshtruar procedurës së vlerësimit nga stafi i Zyrës, dhe pas vërtetimit se ato përmbushin të gjitha kërkesat që dalin nga legjislacioni primar dhe sekondar për energjinë në Kosovë si, dhe nga Ligji për Shoqëritë Tregtare, Zyra ka lëshuar 5 (pesë) Licenca për furnizim/tregti me energji elektrike.

VAZHDIMI I LICENCAVE

Licencat për furnizim/tregti me energji elektrike jepet për një periudhë dy (2) vjeçare, ndërsa ato mund të vazhdohen edhe për një periudhë dyvjeçare. Nga të gjitha kompanitë të cilave u është afuar skadimi i afatit pesë (5) prej tyre kanë kërkuar nga ZRRE vazhdimin e afatit të licencave. Pas vlerësimit të kërkesave dhe vërtetimit se ato janë në pajtueshmëri me legjislacionin e theksuar nën pikën 2.5.1, Zyra ua ka vazhduar pesë (5) kompanive afatin e licencave për furnizim/tregti me energji elektrike edhe për dy (2) vjet.

Pasi që kërkesat për vazhdim të licencave duhet të bëhen gjashtë (6) muaj para skadimit të afatit të tyre, ZRRE në fund të këtij viti ka pranuar edhe tri (3) kërkesa për vazhdim të licencave ekzistuese për furnizim/tregti me energji elektrike. Të gjitha këto kërkesa janë në procedurë të vlerësimit nga Zyra. Vendimet lidhur me kërkesat do të nxirren gjatë muajit maj 2009.

PËRFUNDIMI I LICENCAVE

Ndërmarrja OstElektra GmbH ka qenë e licencuar nga ZRRE për një periudhë dyvjeçare (30 tetor 2006 deri 30 tetor 2008) dhe më 29 gusht 2008 ka kërkuar nga ZRRE përfundimin e licencës së saj. ZRRE më 18 shtator 2008, me Vendimin Nr. V_117_2008, ka përfunduar licencën në fjalë:

Ndërsa, ndërmarrja "Holding Slovenske Elektrane D.O.O" gjithashtu ka qenë e licencuar nga ZRRE për një periudhë dyvjeçare (30 tetor 2006 deri 30 tetor 2008), mirëpo e njëjta nuk ka kërkuar vazhdim licence, prandaj i ka skaduar afati i licencës.

Të gjitha vendimet mbi dhënien e licencave, si dhe licencat e lëshuara janë të publikuara në faqen elektronike të ZRRE-së: www.ero-ks.org

MONITORIMI I AKTIVITETEVE TË LICENCUARA

Në bazë të kompetencave të dhëna me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, nenet 15 dhe 54, ZRRE ushtron mbikëqyrje të aktiviteteve të licencuara se a janë në pajtueshmëri me konditat e licencës, si po zbatohen tarifat dhe çmimet dhe si po zbatohen aktet, vendimet dhe udhëzimet e lëshuara për të licencuarin.

Duke u bazuar në këtë që u tha më lart, gjatë periudhës prej 28 janarit 2008 deri më 1 shkurt 2008, monitorimit të ZRRE-së, në vend të ngjarjes, i janë nënshtruar kompanitë e licencuara të energjisë, përfshirë divizionet përkatëse; më saktësisht: Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) SHA, Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) SHA, Ngrohtorja e Qytetit (NQ) Termokos SHA dhe Ngrohtorja e Qytetit (NQ) Gjakova SHA. Monitorimi i të licencuarve për periudhën monitoruese 2007 ka përfshirë këto fusha kryesore:

- Përmbushjen e kushteve të licencave me theks të veçantë në:

- shthurjen e llogarive kontabël për aktivitetet e licencuara,
- pajtueshmërinë me kodet teknike dhe rregullat e tregut, dhe

- raportimin periodik siç përcaktohet me Doracakun e Raportimit;

- Zbatimin e kornizës rregullative të miratuar nga ZRRE-ja; dhe

- Implementimin e tarifave dhe realizimin aktual të inputeve të parashikuara për përcaktimin e të ardhurave të lejuara.

Monitorimi paraqet një mënyrë efikase të mbikëqyrjes së të licencuarve dhe ka pasur si synim arritjen e këtyre objektivave:

- Vlerësimin e nivelit të përmbushjes së obligimeve të dala nga licencat përkatëse dhe korniza rregullative, nga ana e të licencuarve;

- Identifikimin e saktë të mangësive dhe çështjeve që kërkojnë zgjidhje në drejtim të përmbushjes së obligimeve; dhe

- Planifikimin e aktiviteteve të ZRRE-së, në kuptim të përcaktimit të kërkesave dhe udhëzimeve specifike për të licencuarit dhe masave konkrete që duhen ndërmarrë nga secila palë në mënyrë që të eliminohen mangësitë dhe të zgjidhen çështjet e identifikuar.

Lidhur me monitorimin e cekur më lart, ZRRE ka përpiluar një raport voluminoz prej mbi 100 faqesh, i cili u është dërguar të gjitha palëve me interes, ndërsa të licencuarit, me shkresa të posaçme, janë njoftuar lidhur me mospërmbushjen e kushteve të licencave si dhe afatet kohore dhe veprimet që duhet ndërmarrë për t'i përmbushur ato.

3. SEKTORI I ENERGJISË ELEKTRIKE

3.1 KAPACITETET PRODHUESE DHE TRANSMETUESE

Kapacitetet prodhuese të energjisë elektrike për furnizimin e konsumatorëve të Republikës së Kosovës janë kryesisht termike - 98 %. Këto kapacitete përbëhen nga dy termocentrale: TC Kosova A dhe TC Kosova B, ndërsa pjesën tjetër e përbëjnë hidrocentralet: HC Ujmani dhe HC Lumëbardhi me pjesëmarrje rreth 2%.

Tab. 3.1 Kapacitetet prodhuese

Njësia	Viti i ndërtimit MW	Kapaciteti i dizajnuar MW	Kapaciteti i Gjenerator MW	Kapaciteti operativ System operativ MW
A1	1962	65	35	32
A2	1964	125	-	-
A3	1970	200	135	120
A4	1971	200	135	120
A5	1975	210	145	130
TC Kosova A		800	450	402
B1	1983	339	290	265
B2	1984	339	280	260
TC Kosova B		678	570	525
HPP Ujmani	1981	35	35	35
HPP Lumëbardhi	1957/2005	8	8	8
Total		1,521	1,063	970

Siç shihet edhe nga tabela e mësipërme, në saje të vjetërsisë dhe mirëmbajtjes joadekuate, kapaciteti operativ i njësive prodhuese të njësive termike është dukshëm më i ulët në krahasim me kapacitetin e dizajnuar.

Rritja e konsumit dhe zvogëlimi i kapaciteteve operative prodhuese bëjnë që Kosova të përballet me mungesë të kapaciteteve në fuqi dhe energji. Kësaj mund t'i shtohet edhe mbingarkimi i kapaciteteve transmetuese dhe distributive. Kështu edhe më tej në disa rajone paraqiten fyte të ngushta (ngulfatje) e si pasojë e kësaj edhe rënie e tensionit nën vlerën nominale.

KAPACITETET BARTËSE NË TRANSMISION

Gjatë viteve 2000-2008 ka pasur investime në ngritjen e kapaciteteve në rrjetin e transmisionit. Këto investime kanë ndikuar që të rritet fuqia transmetuese në rrjetin e transmisionit.

Gjatë vitit 2008 janë bërë investime në ngritjen e kapaciteteve transmetuese. Investimet më të rëndësishme janë:

- Rritja e seksionit të përçuesit në LP 110 kV: Kosova A-Vushtrria 2, Vushtrria 2 – Vushtrria 1, Prizren 2–Prizren 1;
- Ndërtimi i LP 110 kV Prizreni 2 – Rahovec, i cili pritet të lëshohet në punë në maj të vitit 2009 me lëshimin në punë të nënstacionit 110/35/10 kV Rahoveci;
- Ndërrimi i mbrojtjeve Rele në nënstacionet Kosova B dhe Prishtina 4;
- Fillimi i ndërtimit të nënstacionit Peja 3 400/110 kV;
- Janë bërë edhe investime të tjera në përmirësimin e gjendjes operuese në nënstacione.

Në dhjetor të vitit 2008 është dëmtuar transformatori energjetik i nivelit 220/110 kV, me fuqi 100 MVA në nënstacionin Kosova A. Kjo ka ndikuar në zvogëlimin e kapacitetit transmetues.

Më poshtë është dhënë tabela me nënstacionet, numrin e transformatorëve dhe fuqinë e instaluar sipas nivelit të transformimit, e po ashtu edhe gjatësia e linjave sipas nivelit të tensionit.

Tab. 3.2 Transformorët dhe linjat në rrjetin e transmisionit

Tensioni	Gjatësia	Tensioni (kV/kV)	Pronari	Nr. i NS	Nr. i TR	Fuqia (MVA)
kV	km	400/220	KOSTT	1	3	1,200
400	181.4	220/110	KOSTT	3	6	900
220	231.9	220/35/(20)/10	KOSTT	1	2	80
110	645.0	220/35/10(20)	Alferon	1	2	320

Rajonet kryesore në të cilat paraqiten ngulfatje janë dy (rajoni i Dukagjinit dhe i Ferizajt). Ndërtimi i nënstacionit Peja III 400/110 kV, në të cilin kanë filluar punët nga fundi i vitit 2008, do të mundësojë që rajoni i Dukagjinit, që përbën pjesën më të mbingarkuar, ta zgjidhë këtë çështje duke rritur sigurinë dhe kualitetin e furnizimit të konsumatorëve. Mbetet të zgjidhet edhe problemi me ngulfatje (fyte të ngushta) në rajonin e Ferizajt, për të cilin janë paraparë investime në vitet e ardhshme.



Fig.3.1 Rrjeti i transmisionit të Kosovës

KAPACITETET BARTËSE NË DISTRIBUCION

Rrjeti i distribucionit në pjesën më të madhe është i mbingarkuar dhe i vjetruar. Me gjithë investimet e viteve të fundit në riparimin dhe zhvillimin e tij, prapëseprapë mbesin të shumta ngulfatjet në disa pjesë. Ndikim të madh në rritjen e mbingarkesës së rrjetit ka rritja e konsumit të përgjithshëm, sidomos në amvisëri.

Investimet më të rëndësishme në rrjetin distributiv gjatë vitit 2008 janë:

- Ndërtimi i nënstacionit 110/35/10 kV Rahoveci (sipas planit, lëshimi në punë pritet në muajin maj 2009);
- Investimet në përforcimin e rrjetit distributiv me vlerë rreth 5 000 000 euro.

Më poshtë janë paraqitur tabelat me gjatësinë e linjave sipas nivelit të tensionit të ndarë në kabllorë dhe ajror. Gjithashtu, janë të prezantuara edhe nënstacionet, duke përfshirë numrin e transformatorëve dhe fuqinë e tyre.

Tab. 3.3 Linjat e rrjetit të distribucionit

Tensioni	Rrjeti ajror	Rrjeti kabllor	Gjatësia
kV	km	km	km
35	647.7	26.4	674.1
20	245.0	94.4	339.4
10	4,779.4	764.6	5,544.0
6	46.8	0.4	47.2
0.4	11,314.7	467.8	11,782.5

Tab. 3.4 Transformatorët e kyçur në rrjetin e distribucionit

Tensioni (kV/kV)	Pronari	Nr. i NS	Nr. i TR	Fuqia (MVA)
110/35/10(20)	KEK	1	1	32
110/35	KEK	11	21	673
110/(20)10	KEK	3	6	206
110/10	KEK	8	13	410
110/35/6.3	Trepça	1	2	63
110/35	Trepça	-	2	126
110/6.3	Sharri	1	2	40
110/35	Ujmani	1	1	20
35/10	KEK	53	104	671
(10)20/0.4	KEK	694	705	133
10/0.4	KEK	5,106	5,207	1,455
6/0.4	KEK	31	31	6

3.2 PRODHIMI DHE SHPENZIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE

Prodhimi i linjtit

Linjiti përbën rezervën më të madhe të burimit natyror të energjisë në Republikën e Kosovës. Shfrytëzimi i tij nga termocentralet mundëson prodhimin e energjisë elektrike për furnizimin e konsumatorëve.

Dy mihjet e hapura të linjitit furnizojnë termocentralet Kosova A dhe Kosova B me kapacitet mbi 7 milionë tonelata për vit. Nga tërë sasia e prodhuar një pjesë fare e vogël përdoret për shitje në tregun e lirë.



Fig.3.2 Mihje e linjitit në Kosovë

Nga grafiku i mëposhtëm vërehet një tendencë gjithnjë në rritje e konsumit të linjitit si pasojë e nevojës në rritje të prodhimit të energjisë elektrike. Krahas prodhimit, vërehet një rritje konstante ndër vite e konsumit të energjisë elektrike, çka do të shkaktojë që këto mihje deri në vitin 2012 apo edhe më herët të harxhohen plotësisht. Kjo ka nxitur intensifikimin e hapjes së minierës së re në juglindje të Sibovcit. Hapja e kësaj miniere do ta zgjidhë çështjen e furnizimit me linjit të centraleve ekzistuese, por njëherit edhe atyre që planifikohen të ndërtohen në të ardhmen.




Fig. 3.3 Prodhimi dhe konsumi i linjitit, 2005-2008

Tab. 3.5 Prodhimi dhe konsumi i linjitit 2005-2008

Prodhimi & Konsumi i Linjitit	Realizimi 2005	Realizimi 2006	Realizimi 2007	Realizimi 2008	Bilanci 2008	Realiz/Bilanci 2008	Realizimi 2008/2007
Gjithsej prodhimi i linjitit (t)	6,536,759	6,532,355	6,715,352	7,742,037	7,200,000	107.53%	115.29%
Gjithsej konsumi i linjitit (t)	5,796,658	5,830,253	6,824,892	7,278,548	6,890,555	105.63%	106.65%

Prodhimi i energjisë elektrike

Siguria dhe stabiliteti në punë në dy termocentralet Kosova A dhe Kosova B është zvogëluar dukshëm vitet e fundit për shkak të vjetërsisë dhe mirëmbajtjes joadekuate në periudha të ndryshme kohore.

Tab. 3.6 Prodhimi i energjisë elektrike neto për periudhën 2004 - 2008

Prodhimi / Njësitë prodhuese	Realizimi 2004 (MWh)	Realizimi 2005 (MWh)	Realizimi 2006 (MWh)	Realizimi 2007 (MWh)	Realizimi 2008 (MWh)	Bilanci 2008 (MWh)	Realiz/Bilanci 2008 (MWh)
A1	5 345	64 542	7 609	- 5 932	- 5 776	0	0.00%
A3	281 154	- 2 775	347 551	653 485	721 764	318 780	226.41%
A4	115 004	- 1 167	- 1 046	565 878	428 167	370 944	115.43%
A5	450 725	584 350	544 416	10 379	53 323	297 528	17.92%
TC Kosova A	852 228	644 950	898 529	1 223 810	1 197 478	987 252	121.29%
B1	1 433 543	1 476 759	1 376 516	1 726 957	1 483 590	1 679 940	88.31%
B2	1 083 423	1 767 575	1 595 667	1 288 556	1 770 199	1 740 528	101.70%
TC Kosova B	2 516 966	3 244 334	2 972 182	3 015 513	3 253 789	3 420 468	95.13%
SHA Kosova Thëngjilli	803	778	0	0	0	0	0.00%
HC Ujmani	113 346	109 682	99 562	70 076	53 335	76 000	70.18%
Hc Distributive	0	0	26 624	23 588	22 322	26 661	83.73%
Total prodhimi	3 483 343	3 999 744	3 996 897	4 332 987	4 526 924	4 510 381	100.37%
Marrje (Imp+Shk)	483 580	490 632	536 238	642 349	708 195	437 400	161.91%
Dhënie (Eksp+Shk)	194 665	225 965	252 527	378 868	295 696	35 691	828.49%

Njësitë A3, A4 dhe A5 janë në gjendje më të mirë pas rehabilitimit dhe janë shfrytëzuar gjatë vitit 2008, ndërsa A1 si njësi më e vjetër punon me një kapacitet të zvogëluar dhe me efikasitet shumë të ulët, me ndotje në masë të madhe të ambientit, prandaj përdorimi i saj mbetet vetëm për raste tejet emergjente. Njësia A2 është jashtë përdorimit dhe e dekomisionuar.

Një situatë më e mirë qëndron me termocentralin Kosova B. Të dy njësitë e këtij termocentrali kanë qenë në punë pothuajse gjatë tërë vitit me një efikasitet të lartë, duke kontribuar me rreth 72% në prodhimin e gjithëmbarshtëm.



Fig.3.4 Pamje e TC Kosova B

Kosova një pjesë të vogël të prodhimit të energjisë e mbulon përmes hidrocentraleve të cilat kanë një kapacitet të vogël instalues. Gjatë vitit 2008 në funksion ka qenë hidrocentrali i “Ujmanit” me kapacitet të instaluar prej 35 MW e që është i administruar nga kompania e ujit hidrosistemi “Ibër-Lepenc” në Prishtinë.

Një pjesë e gjenerimit po ashtu është realizuar nga hidrocentrali i “Lumëbardhit” i dhënë me koncesion një ndërmarrjeje private, dhe hidrocentrali i “Radavcit”, i cili është në pronësi të KEK-ut. Këta prodhues janë të kyçur në rrjetin e distribucionit.




Fig. 3.5 Realizimi i prodhimit gjatë vitit 2008

Prodhimi i energjisë elektrike në vitin 2008 është realizuar sipas bilancit elektroenergjetik 2008 me disa përjashtime të vogla, kryesisht për shkak të ndryshimit kohor të riparimeve të njësive prodhuese.

Prodhimi neto i energjisë elektrike në TC në vitin 2007 ka qenë 4 239 GWh, ndërsa në vitin 2008 ka qenë 4 451 GWh dhe ka pësuar një ngritje prej 5.0%. Prodhimi në HC ka pasur një rënie prej 19.2%, megjithatë ajo ka pasur pak ndikim në prodhimin e gjithëmbarshtëm të energjisë elektrike në vitin 2008. Në përgjithësi gjatë vitit 2008 krahasuar me vitin 2007 ka pasur një rritje të prodhimit të energjisë elektrike për 4.5%.

Konsumi i energjisë elektrike

Konsumi i përgjithshëm në vitin 2008 ka shënuar rritje prej 7.85% krahasuar me vitin 2007.

Në tabelën e mëposhtme janë dhënë shënimet për konsumin sipas kategorive të konsumatorëve në baza mujore për vitin 2008 në nivelin e distribucionit dhe harxhuesit në nivelin 110 kV.

Tab. 3.7 Konsumi sipas kategorive tarifore në vitin 2008

Grupet tarifore	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Totali
	MWh	MWh	MWh	MWh	MWh	MWh	MWh	MWh	MWh	MWh	MWh	MWh	MWh
110kV (Trepça + Sharrcem)	2,965	7,168	8,050	8,095	7,562	7,562	7,528	7,763	6,893	8,067	7,532	5,126	84,311
35 kV	4,063	3,883	3,580	3,226	2,822	2,664	2,472	3,008	2,814	3,204	4,453	5,404	41,593
10 kV	17,410	15,783	14,695	14,601	13,501	12,808	12,729	13,137	13,106	15,098	15,103	16,275	174,246
Amvisëria nën 200 kWh/muaj dhe spitalet	40,315	40,844	41,425	41,765	42,085	41,430	42,719	43,809	42,897	43,975	43,961	38,530	503,755
Amvisëria prej (201kWh deri në 600kWh)/muaj	54,659	60,366	57,468	47,796	46,576	42,497	40,286	45,440	46,249	51,257	52,027	49,725	594,346
Amvisëria mbi 600 kWh/muaj	54,964	52,789	44,114	46,446	37,749	35,000	26,191	25,749	32,828	33,979	38,710	51,279	479,798
0.4 kV I	11,880	11,845	11,210	11,066	10,548	10,146	11,045	12,784	11,721	13,133	13,318	12,287	140,983
0.4 kV II	30,232	31,461	29,601	26,360	28,362	25,139	24,672	26,991	25,126	24,008	28,951	25,219	326,122
Ndriçimi publik	815	565	357	685	833	596	473	612	601	644	918	827	7,926
Konsumatorët në amvisëri pa njehsor	6,637	6,550	6,474	6,469	6,423	6,419	6,416	6,408	6,401	6,385	6,396	6,370	77,348
Total	223,940	231,254	216,974	206,509	196,461	184,261	174,531	185,701	188,636	199,750	211,369	211,042	2,430,428

Përveç në distribucion, rritje të konsumit kanë pësuar edhe konsumatorët e kualifikuar dhe konsumatorët e drejtpërdrejtë. Kjo posaçërisht është influencuar nga "Alferoni" (Ferronikeli), i cili ka pasur një rritje të konsumit të energjisë prej 219.10% në krahasim me vitin e kaluar.

Tab. 3.8 Krahasimi i konsumit 2007 - 2008

Harxhuesi	2007 MWh	2008 MWh	%
Distribucioni neto	2,093,372	2,363,276	12.89%
Humbjet në Distribucion	1,941,704	1,769,502	-8.87%
Ngarkimi Distribucion	4,035,076	4,132,778	2.42%
Trepça+Sharrcemi	76,824	83,363	8.51%
Ferronikeli	122,246	390,083	219.10%
Kosova Thëngjilli+Kons.jashtë KEK	5,500	1,255	-77.18%
Konsum. intern të KEK +SS Palaj	77,538	121,421	56.60%
Total harxh. jashtë Distribucionit	282,108	596,122	111.31%
Humbjet në Bartje	266,533	214,814	-19.40%
Totali	4,583,717	4,943,714	7.85%

Konsumi më i lartë i realizuar gjatë këtij viti ka qenë në sezonin e dimrit dhe atë në orët e mbrëmjes. Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur pesë vlerat më të larta (piku) të realizuara gjatë vitit 2008. Nga tabela mund të vërehet se ngarkesa maksimale e arritur gjatë këtij viti është ajo e datës 17 shkurt 2008 në orën 21, e cila ishte 967 MW. Këto vlera janë arritur duke e mbingarkuar rrjetin transmetues dhe nuk mund të konsiderohen si vlera që vlejné për periudha më të gjata të transmetimit.

Tab. 3.9 Pesë vlerat më të larta (maksimale) gjatë vitit 2008

Ora	Piku (MW)	Data	Numri i javës	Piku zbritës
21	967	17/02/2008	7	Piku i parë
20	963	22/12/2008	52	Piku i dytë
21	961	29/09/2008	40	Piku i tretë
20	961	20/12/2008	51	Piku i katërt
22	946	7/12/2008	49	Piku i pestë

Si prodhimi edhe konsumi kanë pësuar një rritje përgjatë viteve. Nga grafiku i mëposhtëm vërehet se rritja më e madhe është te prodhimi i cili në vitin 2000 ka qenë 1 913 GWh, ndërsa në vitin 2008 ka arritur në 4 527 GWh. Shprehur në përqindje, rezultojnë se prodhimi nga viti 2000 deri në vitin 2008 ka pësuar një ngritje prej 136.6%. Përderisa konsumi në vitin 2000 ka qenë 2 835 GWh, në vitin 2008 ka arritur në 4 944 GWh, që në përqindje rezultojnë që rritja të jetë 74.4%.




Fig. 3.8 Prodhimi në prag dhe konsumi bruto, 2000-2008

Furnizimi i konsumatorëve – Skema ABC

Gjatë vitit 2008, KEK-u nuk i ka furnizuar rregullisht konsumatorët me energji elektrike. Furnizimi i konsumatorëve është bërë sipas skemës ABC të reduktimeve. Sipas kësaj skeme furnizim më të mirë kanë konsumatorët të cilët janë pagues të rregullt të energjisë elektrike dhe kanë humbje të vogla komerciale, ndërsa furnizim më të reduktuar kanë konsumatorët të cilët nuk janë pagues të rregullt të energjisë elektrike dhe kanë humbje më të mëdha komerciale.

Në bazë të raporteve për furnizimin e realizuar sipas skemës ABC, gjatë vitit 2008, kategoria A ka qenë e furnizuar me energji elektrike 24:0 ose 5:1, kategoria B ka qenë e furnizuar me 5:1 ose 4:2 dhe kategoria C me 4:2 ose 3:3.

Kriter për përcaktimin e kategorizimit ABC deri në dhjetor 2007 ka qenë përqindja e arkëtimit sipas daljeve 10 kV.

Skema ABC ndryshon çdo muaj. Kriter për përcaktimin e kategorizimit ABC deri në dhjetor të vitit 2007 ka qenë përqindja e arkëtimit sipas daljeve 10 kW, ndërsa pas dhjetorit 2007 kriteret janë:

- Përqindja e arkëtimit në raport me energjinë e faturuar sipas daljeve 10 kV për muajin e caktuar
- Përqindja e humbjeve komerciale sipas daljeve 10 kV për muajin e caktuar

Zbatimi i kësaj skeme privilegjon konsumatorët e rregullt në pagesën e energjisë elektrike, mirëpo i sanksionon konsumatorët të cilët janë pagues të rregullt të energjisë elektrike por që furnizohen nga daljet 10 kW të cilat janë në kategorinë B dhe C.

Në bazë të vendimit të Bordit të ZRRE - D_08_2005, KEK-u obligohet që të dorëzojë në ZRRE propozimin për kompensimin e konsumatorëve të cilët janë pagues të rregullt por të klasifikuar në kategorinë B ose C, si dhe të kryejë këtë kompensim. Po ashtu, edhe në raportin e monitorimit është potencuar kërkesa për aplikimin e formave të përshtatshme të kompensimit të konsumatorëve pagues të rregullt të cilët janë në kategorinë B ose C, deri në fund të shtatorit 2008.

Me gjithë kërkesat e cekura më lart, KEK-u ende nuk ka dorëzuar në ZRRE propozimin e vet për kompensimin e konsumatorëve pagues të rregullt, të cilët janë brenda kategorive B ose C.


3.3 TREGU I ENERGJISË ELEKTRIKE

Nga mesi i viteve të 80-ta një numër i madh i vendeve evropiane dhe botërore kanë hyrë në reformën e tregut me iniciativa si liberalizimi, privatizimi dhe/ose ristrukturimi i furnizimit me energji elektrike.

Motivi për ndërrimin e organizimit të kësaj industrie është i ndryshëm, por në formë gjenerale bëhet për të mundësuar konkurrencën, në mënyrë që të arrihet efikasitet më i lartë, çmime më transparente dhe transferimi i një pjese të rrezikut te investitorët privatë e jo vetëm te taksapaguesit. Me këtë ngrihet produktiviteti, racionalizohet më mirë puna dhe kostoja e lëndës djegëse, zgjidhen teknologji më të reja dhe që të gjitha sjellin deri te një kosto më e ulët dhe shërbime më kualitative për konsumatorët.

Për një funksionim më të mirë të tregut të energjisë elektrike, posaçërisht kur kemi parasysh zona të vogla në të cilat shpesh mund të ketë probleme me balancimin (mungesë apo tepriçë të energjisë elektrike), është bërë liberalizimi i tij, sepse një treg i lirë është nxitës për cilësi më të mirë të furnizimit, kosto më të ulët dhe siguri më të madhe të furnizimit.

Në balancimin e sistemit elektroenergetik ndikim me rëndësi kanë edhe shërbimet e sistemit dhe shërbimet ndihmëse. Në grafikun e mposhtëm është paraqitur ndikimi i këtyre shërbimeve.



Për funksionim efikas, transparent dhe jodiskriminues të tregut është i nevojshëm ekzistimi i rregullimit, e sidomos rregullimi i shërbimeve dhe aktiviteteve që janë si monopol natyror.

Në disa shtete të SHBA-së, rregullimi ka filluar së aplikuari qysh në vitin 1907, ndërsa në Evropë, Britania e Madhe në vitet e 80-ta futi së pari agjencinë rregullative bazuar nga përvojat e SHBA-së.

Me nënshkrimin e Traktatit të Komunitetit të Energjisë së Evropës Juglindore, Kosova merr obligimin e zbatimit të kërkesave që dalin nga Traktati, duke përfshirë rregulloret dhe direktivat e BE-së lidhur me energjinë. Përbushja e këtyre obligimeve paraqet një imperativ dhe detyrë të vazhdueshme. Një progres në përbushjen e këtyre obligimeve është arritur me fillimin e shthurjes së kompanisë vertikalisht të integruar, KEK-ut, nga ku u krijua KOSTT-i që tani operon si entitet i veçantë i bartjes (transmisionit) dhe është i licencuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji, si Operator i Tregut dhe Operator i Sistemit të Bartjes. Pjesa tjetër, që përmban mihjet, distribucionin dhe furnizimin janë nën menaxhimin e KEK-ut.

Sthurja e mëtutjeshme pritet të intensifikohet me ndarjen e distribucionit dhe furnizimit duke krijuar një kompani me investime të përbashkëta e cila më vonë pritet të privatizohet. Kjo është sforcuar edhe me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, ku kërkohet shthurja e KEK-ut deri më 31.03.2009 dhe krijimi i kompanisë për distribuim dhe furnizim me energji elektrike si kompani me investime të përbashkëta (J.S.C).

Hap tjetër në hapjen e tregut është bërë me ndryshimin e procesit të fitimit të statusit të konsumatorit të kualifikuar (privileguar) ku të drejtën e tillë mund ta fitojnë nga:

- 1 janar 2006, konsumatorët e kyçur në tensionin 110 kV e më lart.
- 1 janar 2007, konsumatorët e kyçur në tensionin 35 kV e më lart.
- 1 janar 2008, konsumatorët e kyçur në tensionin 10 kV e më lart, të cilët kanë linjë të veçantë.
- 1 janar 2009, konsumatorët e kyçur në tensionin 10 kV e më lart, të cilët kanë mbetur pa përfshirë në vitin 2008.

Në kuadër të aktiviteteve sensibilizuese, MEM, ZRRE, KOSTT dhe KEK gjatë vitit 2008 kanë organizuar takime pune me konsumatorë të mëdhenj industrial, me qëllim të ngritjes së vetëdijes së këtyre konsumatorëve për mundësitë dhe efektet pozitive në afarizmin e tyre që ofron statusi i konsumatorit të kualifikuar.

Megjithatë, për shkak të mungesës së energjisë elektrike dhe të çmimeve të larta në tregun e lirë krahasuar me çmimet e rregulluara, numri i të interesuarve për fitimin e statusit të konsumatorit të kualifikuar është i vogël. Në këtë aspekt po ashtu ka ndikim pamundësia për të zgjedhur furnizues të ndryshëm, edhe pse këtë e mundësojnë Rregullat e Tregut.

Në planin rajonal ka pasur aktivitete rreth hapjes së tregut, por jo realizime konkrete. Në këtë ka kontribuar edhe mungesa e energjisë në tërë rajonin. Por, në kuadër të Komunitetit të Energjisë janë duke u bërë përpjekje në këtë drejtim. Kështu janë në rrjedhë e sipër aktivitetet për implementimin e Zyrës së Aukcionit të Koordinuar (CAO) për alokimin e kapaciteteve të interkoneksionit. Është duke u punuar Plani i monitorimit të Tregu për EJL, në harmonizimin në nivel rajonal të Licencave dhe rregullave të tregut. Kjo mbetet të vazhdohet edhe gjatë vitit 2009.

Në këtë periudhë janë caktuar firma konsulente për të kryer studimin për integrimet e tregut me shumice në EJL - "POYRY", të cilat kanë mbajtur takime me anëtarët e EJL dhe do të propozojnë dizajnin e tregut me shumicë.

Pastaj firma konsulente për përcaktimin e pengesave ligjore për operim dhe pjesëmarrje në SEE CAO "Kelemenis & Co" që po ashtu do të organizojnë takime me të gjithë anëtarët e rajonit.

3.4 IMPORTI DHE EKSPORTI I ENERGJISË ELEKTRIKE

Furnizimi me energji kualitative dhe çmime sa më të volitshme është objektiv fundamental i sektorit të energjisë. Për arritjen e këtij objekti duhen përpjekje të mëdha dhe funksionim i koordinuar i prodhimit të thëngjillit, prodhimit të energjisë elektrike, bartjes, distribuimit, shkëmbimit etj.

Në Kosovë edhe më tutje ka pasur mungesë të energjisë elektrike që ka rezultuar me reduktime të konsiderueshme dhe import mjaft të madh si dhe çmime të larta. Natyrisht kur kemi parasysh se sistemi kosovar është i dizajnuar për prodhim të energjisë bazë e jo për atë balancuese, janë paraqitur edhe teprica të cilat është dashur të eksportohen.

Tab.3.10 Importi dhe eksporti, 2008:

Lloji	Import			Eksport			Shkëmbim			Total		
	Muaji	Sasia MWh	Çmimi (€)	Vlera (€)	Sasia MWh	Çmimi (€)	Vlera (€)	Marrje MWh	Dhënie MWh	Ndrysh MWh	Marrje MWh	Dhënie MWh
1	66,741	106.13	7,083,381.72	0		0.00	4,940	80	4,860	71,681	80	-71,601
2	75,280	106.23	7,996,898.72	0		0.00	16,658	80	16,578	91,938	80	-91,858
3	31,296	102.40	3,204,709.92	9,360	32.95	308,410.00	7,850	5,450	2,400	39,146	14,810	-24,336
4	0		0.00	29,397	31.66	930,706.00	47,080	0	47,080	47,080	29,397	-17,683
5	0		0.00	19,120	32.07	613,267.50	60,561	900	59,661	60,561	20,020	-40,541
6	0		0.00	18,639	35.93	669,695.74	10,580	2,708	7,872	10,580	21,347	10,767
7	0		0.00	17,761	39.65	704,277.77	0	18,730	-18,730	0	36,491	36,491
8	50,582	99.40	5,027,949.40	4,505	40.16	180,905.70	40,400	37,214	3,186	90,982	41,719	-49,263
9	44,552	109.13	4,862,026.93	14,000	45.22	633,019.55	0	26,557	-26,557	44,552	40,557	-3,995
10	60,751	126.77	7,701,435.24	9,205	44.46	409,291.01	400	31,140	-30,740	61,151	40,345	-20,806
11	63,408	125.22	7,939,969.40	3,290	40.79	134,206.10		20,490	-20,490	63,408	23,780	-39,628
12	65,207	118.04	7,697,086.70	0		0.00	61,909	27,070	34,839	127,116	27,070	-100,046
Total	457,817	112.52	51,513,458.03	125,277	36.59	4,583,779.37	250,378	170,419	79,959	708,195	295,696	-412,499

Në bazë të raportit të importit dhe eksportit për vitin 2008 rezulton se çmimi mesatar i energjisë së importuar është i lartë, ndërsa i energjisë së eksportuar i ulët. Nga tabela mund të shohim se sasia e energjisë e importuar me kontrata në vitin 2008 është 457,817 MWh me një vlerë prej 51,513,458.03 €. Çmimi mesatar i energjisë së importuar gjatë këtij viti është 112.52 €/MWh. Këtu duhet cekur se energjia e importuar është kryesisht në tarifën e lartë që nënkupton edhe çmim më

të lartë. Përveç kësaj energjie elektrike të importuar, KEK-u ka importuar edhe energji në formë shkëmbimi në sasi 250,378 MWh.




Fig. 3.7 Importi me kontrata dhe si shkëmbim, 2008

Eksporti me kontrata është 125,277 MWh me një vlerë të gjithmbarshme prej 4,583,779.37 €. Çmimi mesatar i energjisë së eksportuar është 36.59 €/MWh dhe kjo është kryesisht energji e tarifës së ulët. Po ashtu, është eksportuar energji elektrike në formë shkëmbimi në sasi 170,419 MWh.




Fig. 3.8 Eksporti me kontrata dhe si shkëmbim, 2008

Në përgjithësi KEK-u ka pasur import (kontrata+shkëmbim) 708,195 MWh, ndërsa eksport (kontrata+shkëmbim) 295,696 MWh. Importi është më i lartë se eksporti për 412,499 MWh. Nëse kësaj i shtojmë edhe reduktimet e realizuara vijmë deri te ndryshimi në mes prodhimit dhe kërkesës në vitin 2008, ku shihet se kërkesa është ende mjaft më e lartë se prodhimi dhe Kosova me këto kapacitete nuk i plotëson nevojat e konsumit. Edhe vet shkëmbimi gjithashtu paraqet një çështje me rëndësi, meqë diferenca e energjisë së shkëmbyer është 79,959 MWh në favor të importit, që do të thotë se KEK-u hyn në vitin 2009 me një borxh bukur të madh në shkëmbime, i cili duhet të kthehet në periudhën në vijim.

Krahasuar me vitin 2007 importi me kontrata në sasi ka pësuar rënie nga 539,812 MWh në vitin 2007 në 457,817 MWh në vitin 2008, por në formë shkëmbimi ka rritje të dukshme nga 83,577 MWh në

250,378 MWh. Eksporti përmes kontratave ka pësuar rënie nga 170,175 MWh në vitin 2007 në 125,277 MWh në vitin 2008, e po ashtu edhe në formë shkëmbimi ka një rënie të vogël.

Krahasimi i çmimit tregon se ka rritje të madhe të çmimit të importit nga 83.66 €/MWh në 2007 në 112.52 €/MWh në vitin 2008, përderisa çmimi i eksportit ndryshon fare pak dhe atë në rënie nga 38.45 €/MWh në 2007 në 36.59 €/MWh në 2008.

Analiza sipas tregtarëve tregon variacione të ndryshme të çmimeve, por e përbashkët është çmimi i lartë i importit, gjersa eksporti shënon vlera pothuaj trefish më të ulëta dhe pothuaj nuk ka ndryshime nga eksporti në vitin 2007.

Analiza sipas tregtarëve tregon variacione të ndryshme të çmimeve, por e përbashkët është çmimi i lartë i importit, gjersa eksporti shënon vlera pothuaj trefish më të ulëta dhe pothuaj nuk ka ndryshime nga eksporti në vitin 2007.

Tab. 3.11 Importi dhe eksporti sipas tregtarëve

Tregtarët	Import			Eksport		
	Sasia	Çmimi imp	Vlera	Sasia	Çmimi exp	Vlera
EFT	220,663	113.29	24,998,522	52,514	33.76	1,773,044
EGL	56,091	103.05	5,780,019	910	43.13	39,253
Rudnap	125,381	114.96	14,413,239	32,526	38.18	1,241,886
Ezpada	16,260	114.45	1,860,900	630	41.88	26,387
GEN I	23,922	111.75	2,673,217	4,495	45.22	203,263
Repower	1,725	103.00	177,675	26,946	37.04	998,119
RE Trading	13,175	116.50	1,534,888			
EPS	600	125.00	75,000			
CEZ				7,256	41.60	301,830
Gjithsej	457,817	112.52	51,513,458	125,277	36.59	4,583,779




Fig. 3.9 Importi dhe eksporti sipas tregtarëve

Nga figura e dhënë më lartë shihet se EFT dominon me sasi të energjisë elektrike të cilën KEK-u e ka importuar, ndërsa çmimin më të lartë e ka RE Trading nëse e anulohet EPS-in, i cili ka dhënë energji emergjente dhe në sasi të fare të neglizhueshme. Po ashtu, EFT prin edhe me sasinë e eksportuar nga KEK-u. Çmimi më i lartë i eksportit është realizuar me GEN I, por në sasi të vogla.

Tab.3.12 Çmimet e energjisë në rajon dhe çmimet e importit në KEK

2008	EEX		DESMIE		OPCOM		IPEX		APX		KEK-Import		
	MWh	€/MWh	MWh	€/MWh	MWh	€/MWh	MWh	€/MWh	MWh	€/MWh	MWh	€/MWh	€
Janar	160,629	68.48	4,633,790	86.16	570,650	56.60	29,382,901	86.24	2,072,997	65.22	66,741	106.13	7,083,382
Shkurt	129,460	65.19	4,279,478	85.60	472,068	52.94	28,037,468	81.49	1,840,100	62.77	75,280	106.23	7,996,899
Mars	168,165	60.07	4,004,371	88.18	445,388	40.30	28,279,622	74.54	1,922,618	61.90	31,296	102.40	3,204,710
Prill	191,914	74.95	3,823,857	77.58	413,599	41.46	26,608,515	80.62	2,037,518	73.84	0		0
Maj	214,260	61.72	4,127,749	85.47	373,346	38.90	27,089,030	80.09	2,121,152	65.65	0		0
Qershor	210,596	80.21	4,734,288	95.70	399,676	50.45	28,536,349	83.49	2,055,170	75.33	0		0
Korrik	221,450	79.39	5,521,788	110.74	394,224	54.84	31,113,127	97.32	2,172,700	71.37	0		0
Gusht	196,045	64.29	5,051,918	105.17	428,708	56.49	25,340,986	90.95	2,125,415	64.37	50,582	99.40	5,027,949
Shtator	194,654	91.59	4,342,979	102.13	411,291	62.24	28,374,248	97.23	2,058,344	89.07	44,552	109.13	4,862,027
Tetor	188,482	100.31	4,026,583	99.96	392,585	64.73	28,892,110	99.07	2,213,916	85.29	60,751	126.77	7,701,435
Nëntor	223,954	77.92	4,059,974	104.53	425,188	61.22	27,834,750	87.65	2,030,126	66.78	63,408	125.22	7,939,969
Dhjetor	192,756	62.88	4,397,232	97.18	480,131	39.39	27,472,189	84.87	2,178,946	59.35	65,207	118.04	7,697,087
Totali	2,292,365	73.92	53,004,007	94.87	5,206,854	51.63	336,961,295	86.96	24,829,002	70.08	457,817	112.52	51,513,458

Një faktor i rëndësishëm është edhe krahasimi i çmimeve të importit të KEK-ut me çmimet rajonale, e cila është paraqitur në tabelën e sipërme, por më mirë pasqyrohet në formë grafike si më poshtë




Fig.3.10 Çmimet e energjisë në rajon dhe çmimet e importit në KEK

3.5 HUMBJET NË SEKTORIN E ENERJISË ELEKTRIKE

Bartja e energjisë elektrike, nga prodhimi deri te konsumatori, është i përcjellë me humbje të fuqisë dhe energjisë në sistem. Vlera e humbjeve në sistemet elektroenergjetike sillet prej 7-14 % të energjisë elektrike në krahasim me konsumin.

Humbjet e energjisë elektrike në sistemin elektroenergjetik ndahen në:

- humbje teknike, dhe
- humbje komerciale (joteknike).

Humbjet teknike janë pasojë e proceseve elektromagnetike në stabilimentet elektroenergjetike gjatë bartjes dhe shpërndarjes së energjisë elektrike. Këto humbje varen nga shumë faktorë, nga të cilët

më të rëndësishëm janë: dendësia e rrjetit, ngarkesa, seksioni i përcjellësve, forma e diagramit ditor të ngarkesës, gjatësia e linjave, etj.

Sistemi elektroenergetik i Kosovës karakterizohet me humbje të mëdha, si teknike ashtu edhe komerciale. Humbjet teknike të vlerësuara janë 17-18 %, ndërsa humbjet komerciale 30 %.

Humbjet në bartje përfshijnë humbjet në sistemin 400, 220 dhe 110 kV (linjave 400, 220 dhe 110 kV dhe transformatorëve 400/220 kV, 220/x kV)

Gjersa konsumi i distribucionit dhe konsumatorëve direkt është 4.706 GWh, humbjet në bartje kanë qenë 215 GWh dhe përbëjnë rreth 4.56% e që konsiderohen si mjaft të larta.

Tab.3.13 Konsumi, humbjet në Bartje dhe Distribucion, 2008

Muajt	Konsumi MWh	Humbjet në Bartje MWh	Humbjet në Distr. MWh
Janar	524 528	26 455	247 238
Shkurt	460 336	21 631	177 414
Mars	453 632	23 603	181 240
Prill	398 507	17 682	132 295
Maj	358 027	12 453	101 233
Qershor	297 270	9 757	59 737
Korrik	320 038	13 097	93 945
Gusht	321 721	12 256	70 011
Shtator	380 162	13 011	125 632
Tetor	425 244	16 927	151 999
Nëntor	462 440	21 782	178 776
Dhjetor	541 809	26 159	249 982
Totali	4 943 714	214 813	1 769 502

Nga tabela 3.10 dhe figura 3.13 konstatohet se humbjet përcjellin konsumin dhe gjatë sezonit dimëror janë më të mëdha se gjatë sezonit të verës ashtu si edhe konsumi. Rritja e konsumit në periudhën e dimrit vjen si pasojë e shfrytëzimit të energjisë elektrike për ngrohje.




Fig.3.10 Konsumi bruto dhe humbjet në Bartje dhe Distribucion, 2008

Sistemi i distribuimit të energjisë elektrike të Kosovës karakterizohet me humbje të larta, si teknike ashtu edhe komerciale që janë më të lartat në rajon. Humbjet e mëdha teknike janë si pasojë e mosinvestimeve dhe mirëmbajtjes jo të duhur të rrjetit të distribuicionit.

Humbjet komerciale janë si pasojë e shfrytëzimit të paligjshëm të energjisë elektrike dhe menaxhimit jo të mirë të kompanisë. Ndikim në rritjen e humbjeve komerciale ka energjia elektrike e pafaturuar në enklava (pjesa veriore e Mitrovicës, Shtërpca, Graçanica dhe fshatrat serbe në komunën e Gjilanit dhe të Dardanës).

Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet zvogëlimit të humbjeve komerciale, që është e lidhur me rritjen e efikasitetit dhe ngritjen e nivelit të menaxhimit në KEK.

Tab.3.14 Humbjet e përgjithshme dhe rritja e konsumit në Distribuicion sipas viteve 2000-2008

Vitet	Ngarkimi MWh	Realizimi MWh	Humbjet		Rritja e konsumit në raport me vitin paraprak	
			MWh	%		%
2000	2,590,594	1,391,482	1,199,112	46.29		%
2001	2,936,950	1,500,737	1,436,212	48.90	2001/2000	13.37
2002	3,085,929	1,895,400	1,190,530	38.58	2002/2001	5.07
2003	3,359,823	1,962,519	1,397,304	41.59	2003/2002	8.88
2004	3,665,742	1,956,097	1,709,645	46.64	2004/2003	9.11
2005	3,883,000	2,010,117	1,872,883	48.23	2005/2004	5.93
2006	3,895,585	1,974,202	1,921,382	49.32	2006/2005	0.32
2007	4,031,297	2,092,057	1,939,241	48.10	2007/2006	3.48
2008	4,132,846	2,363,281	1,769,564	42.82	2008/2007	2.52
Total	31,581,765	17,145,891	14,435,874	45.71	2008/2000	59.53

Nga tabela 3.11 shihet se humbjet e përgjithshme nga viti 2000 deri në vitin 2008 janë 45.71 %. Nëse merret se humbjet e përgjithshme teknike të vlerësuara janë 18% për rrjetin distributiv (ESTAPI- I), atëherë humbjet e përgjithshme komerciale janë 27.5 %.

Siç shihet në tabelën 3.11, ndryshimet sipas viteve janë të vogla dhe edhe pas 9 viteve humbjet teknike dhe komerciale janë shumë të larta.

Një problem tjetër është rritja e konsumit nga viti në vit. Rritja e konsumit kërkon ndërtimin e kapaciteteve të reja distributive dhe zëvendësimin e linjave të vjetra me të reja në mënyrë që të mund t'i plotësojnë standardet për një furnizim kualitativ me energji elektrike.

Në vitin 2000 konsumi i distribuicionit (ngarkesa) ka qenë 2.591 GWh, ndërsa në vitin 2008 ka qenë 4.133GWh. Kjo rritje e konsumit ndikon në rritjen e ngarkesës në pikat shpërndarëse të rrjetit distributiv dhe në rënje të tensionit në pikat fundore të rrjetit shpërndarës.

Humbjet e përgjithshme në distribuicion (teknike dhe komerciale) gjatë vitit 2008 janë 42.82 % dhe në krahasim me vitin 2007 janë më të ulëta për 5%. Humbjet teknike (të vlerësuara) janë 17.05 %, ndërsa humbjet komerciale janë 25.77%.

Tab.3.15 Humbjet sipas distrikteve në Distribuicion, 2008

Distriktet	Ngarkimi MWh	Realizimi MWh	Inkasimi Euro	Humbjet teknike		Humbjet komerciale		Humbjet totale	
				MWh	%	MWh	%	MWh	%
Prishtinë	1,216,825	737,927	52,392,374	172,291	14.16	306,607	25.20	478,898	39.36
Mitrovicë	611,782	203,411	14,319,803	111,417	18.21	296,954	48.54	408,371	66.75
Pejë	483,080	296,165	20,966,072	88,731	18.37	98,184	20.32	186,915	38.69
Gjakovë	198,259	139,993	9,251,952	31,183	15.73	27,084	13.66	58,267	29.39
Prizren	740,157	450,559	31,072,255	149,305	20.17	140,293	18.95	289,598	39.13
Ferizaj	527,051	290,925	20,741,237	95,409	18.10	140,717	26.70	236,126	44.80
Gjilan	355,691	244,302	16,607,410	56,434	15.87	54,956	15.45	111,389	31.32
Total dist.	4,132,846	2,363,281	165,351,104	704,769	17.05	1,064,795	25.76	1,769,564	42.82

Është interesant të shikohet ngarkimi (konsumi) dhe humbjet sipas distrikteve. Në tabelën 3.12 shihet se humbjet teknike dhe komerciale ndryshojnë nga distrikti në distrikt. Humbjet e përgjithshme më të larta janë në distriktet Mitrovicë 66.75 % dhe Ferizaj 44.80 %, ndërsa më të ulëtat në Gjakovë 29.39 % dhe Gjilan 31.44 %.

Në Tabelën 3.10 shihet se distrikti i Prishtinës merr pjesë me rreth 29.43% të konsumit të përgjithshëm në distribucion, mandej vjen distrikti i Prizrenit me 17.91 % të konsumit, ndërsa konsumin më të vogël e kanë distrikti i Gjakovës dhe i Gjilanit respektivisht 4.80 % dhe 8.62 %.




Fig. 3.11 Humbjet në përqindje sipas distrikteve në Distribucion, 2008

Tab. 3.16 Humbjet sipas muajve në Distribucion, 2008

Muajt	Ngarkimi MWh	Realizimi MWh	Inkasimi Euro	Humbjet teknike		Humbjet komerciale		Humbjet totale	
				MWh	%	MWh	%	MWh	%
Janar	468,213	220,975	16,859,397	90,816	19.40	156,423	33.41	247,238	52.80
Shkurt	401,500	224,086	17,062,326	75,516	18.81	101,898	25.38	177,414	44.19
Mars	390,164	208,924	16,015,532	68,635	17.59	112,605	28.86	181,240	46.45
Prill	330,710	198,415	11,628,146	56,440	17.07	75,854	22.94	132,295	40.00
Maj	290,132	188,899	11,277,709	46,820	16.14	54,413	18.75	101,233	34.89
Qershor	236,437	176,700	10,904,317	35,026	14.81	24,712	10.45	59,737	25.27
Korrik	260,949	167,004	10,396,278	39,084	14.98	54,861	21.02	93,945	36.00
Gusht	247,949	177,938	10,883,616	37,027	14.93	32,984	13.30	70,011	28.24
Shtator	307,376	181,744	11,141,970	46,292	15.06	79,340	25.81	125,632	40.87
Tetor	343,682	191,683	15,316,994	55,836	16.25	96,162	27.98	151,999	44.23
Nëntor	382,614	203,838	16,213,742	65,471	17.11	113,305	29.61	178,776	46.72
Dhjetor	473,058	223,076	17,651,078	87,807	18.56	162,175	34.28	249,982	52.84
Totali	4,132,783	2,363,281	165,351,104	704,769	17.05	1,064,732	25.76	1,769,502	42.82

Gjatë vitit 2008 humbjet më të larta janë regjistruar në janar, shkurt, mars, tetor, nëntor dhe dhjetor për shkak të konsumit më të lartë (shfrytëzimit të energjisë elektrike për ngrohje), ndërsa ato më të ulëta në qershor, korrik dhe gusht.




Fig. 3.12 Humbjet teknike dhe komerciale sipas muajve në Distribucion

3.6 AKTIVITETET E ZRRE-SË RRETH NDËRTIMIT TË KAPACITETEVE TË REJA GJENERUESE

Ngjarjet kryesore në vitin 2008 rreth kapaciteteve të reja gjeneruese lidhen edhe më tutje rreth ndërtimit të centralit të ri elektrik të riemërtuar nga ana e Qeverisë së Kosovës si “Kosova e Re”. Siç dihet, nga vitet 2006 dhe 2007, “Projekti Asistenca Teknike Energjia nga Linjiti” (PATEL) është i mbështetur financiarisht nga Banka Botërore dhe udhëhiqet nga Komitetit Drejtues, i cili kryesohet nga Ministria e Ministrisë së Energjisë dhe Minierave. Projekti ka vazhduar aktivitetet për përgatitjen e modelit financiar investiv dhe pakon tenderuese, që priten të finalizohen brenda vitit 2009. ZRRE-ja ka përfaqësuesin në Komitetin Drejtues dhe merr pjesë aktivisht në punën e tij.

Hidrocentrali i Zhurit dhe perspektivat e mundshme të ndërtimit

Duke pasur parasysh “Strategjinë e Energjisë së Kosovës” dhe politikat qeveritare sektoriale, parashihet që në Kosovë të bëhen ndërtime të kapaciteteve të reja gjeneruese nga burimet e ujit. Banka Botërore, brenda projektit PATEL, është duke mbështetur studimin e mundësisë së zhvillimit të projektit të hidrocentralit të Zhurit. Në lidhje me këtë projekt ka pasur studime të fizibilitetit edhe në të kaluarën, dhe studimi i Bankës Botërore ka për detyrë të rifreskojë ato studime dhe të bëjë studimin preliminar të ndikimit në mjedis dhe vlerësimin social.

ZRRE-ja ka marrë pjesë në mënyrë aktive në procesin e përzgjedhjes së kompanisë, e cila do të kryejë studimin. Studimi pritet të kryhet në qershor të vitit 2009.

Kapacitetet e reja gjeneruese nga burimet e rinovueshme

Duke iu referuar synimeve afatgjate të Strategjisë së Kosovës, politikave qeveritare, përkatësisht Vendimit nr. 05/250 për “Masat nxitëse për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme dhe energjisë elektrike nga bashkëprodhimi në Kosove për periudhën 2007 – 2013”, Vendimit 06/2007 mbi “Konsumin e Energjisë Elektrike nga Burimet e Ripërtërishme”, “Studimit të parafizibilitetit për identifikimin e burimeve ujore për hidrocentrale të vogla në Kosovë”, si dhe obligimeve që dalin nga Traktati i Energjisë së Europës Juglindore, në fushën e kapaciteteve të reja

gjeneruese nga burimet e rinovueshme, ZRRE-ja ka filluar të kompletojë legjislacionin dytësor për burimet e rinovueshme të energjisë. Gjatë vitit 2008 ZRRE-ja ka aprovuar Rregullën për Procedurën e Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, e cila përcakton ecurinë për dhënien e një autorizimi për ndërtimin e një kapaciteti të ri gjenerues. Po ashtu, ka zhvilluar dhe aprovuar tarifën nxitëse - “feed-in tarifa” për gjenerimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme (uji dhe era).

Në vitin 2008 ZRRE-ja ka fituar një grant nga “Banka Botërore”, konsulencë për projektin “Krijimi i Kornizës Rregullative nga Burimet e Rinovueshme të Energjisë”, projekt që pritet të fillojë aktivitetin në fillim të vitit 2009.

Gjatë vitit 2008 janë mbajtur shumë takime me investitorë potencialë nga Kosova dhe jashtë, që kanë shprehur interesim për investime në ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga burimet e rinovueshme.

3.7 TARIFAT E ENERGISË ELEKTRIKE

Shqyrtimi i dytë i të Hyrave të Lejuara dhe Tarifave në Sektorin e Energjisë për periudhën rregullative qershor 2008 - mars 2009

Në pajtim me mandatin ligjor, ZRRE-ja përcakton tarifën për shfrytëzuesit përfundimtarë bazuar në kriteret ekonomike, duke marrë në konsiderim edhe përbalueshmërinë e konsumatorëve. Bazuar në metodologjinë e miratuar, të hyrat e lejuara janë përlogaritur ndaras për KEK SHA (Miniera, Gjenerim, Shpërndarje dhe Furnizim) dhe për KOSTT SHA.

Në muajin tetor 2007, ZRRE-ja ka iniciuar shqyrtimin e dytë të tarifave të rregulluara të energjisë elektrike me pakicë, që ju ngarkohen konsumatorëve të rregulluar, si dhe tarifave të shfrytëzimit të sistemit të transmisionit (SHST) dhe të shfrytëzimit të sistemit të shpërndarjes (SHSSH).

Gjatë këtij procesi janë analizuar në mënyrë të detajuar aplikacionet e pranuar nga ndërmarrjet dhe është bërë verifikimi i të dhënave teknike dhe financiare, ku përfshihen edhe shpenzimet operative dhe kapitale të ndërmarrjeve energjetike.

3.7.1 NGARKESAT E RREGULLUARA TË TRANSMISIONIT DHE TË SHPËRNDARJES

Kostot e operatorit të sistemit të transmisionit dhe shpërndarjes mbulohen nga ngarkesat e shfrytëzimit të sistemit (SHS), ngarkesat e kyçjeve të reja, ngarkesat për gjeneratorë, ngarkesat për konsumatorë të rinj, si dhe nga të hyrat për zgjerim të rrjetit.

Ngarkesat për Shfrytëzimin e Sistemit të Transmisionit (SHST)

Ngarkesa për Shfrytëzimin e Sistemit të Transmisionit (SHST) përfshin kostot e kapacitetit (infrastrukturës) që mbulojnë funksionimin, mirëmbajtjen dhe investimin në rrjetin e transmisionit, kostot e operatorit të sistemit, blerjet e shërbimeve ndihmëse, humbjet dhe kostot e operatorit të tregut.

Ngarkesa e Rrjetit të Shpërndarjes (SHSSH)

Ngarkesa për Shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes (SHSSH) përfshin kostot e shërbimeve të rrjetit të shpërndarjes (distribucimit), blerjen e humbjeve, sigurimit të shërbimeve të nevojshme për funksionimin efektiv të rrjetit të shpërndarjes. Këto ngarkesa nuk paraqiten ndaras, ngase janë

transaksione që kryhen brenda divizioneve të KEK SHA, përderisa të mos bëhet shthurja ligjore e divizioneve të KEK-ut.

Tarifat e Rregulluara për Konsumatorët me Pakicë

Në tarifat e rregulluara të konsumatorëve me pakicë përfshihen shuma e kostove të blerjes së energjisë nga gjeneratorët, importi, kostot e rregulluara të transmisionit dhe shpërndarjes dhe kostot fikse të furnizimit. Subvencionet direkte nga BKK, të hyrat nga eksporti, të hyrat nga shitja e energjisë ndaj konsumatorëve të privilegjuar dhe kostot për aktivitetet e parregulluara zbriten nga të ardhurat e lejuara që furnizuesi publik mund t'i mbulojë nga tarifat e rregulluara.

Sipas Rregullës së Çmimeve, për kategorinë e konsumatorëve shtëpiakë janë vendosur tri blloqe tarifore sipas nivelit të konsumit, sipas të cilës konsumatorët shtëpiakë shpërblehen me tarifë më të ulët nëse konsumojnë sipas niveleve të specifikuara në këto blloqe tarifore. Qëllimi i bllok-tarifës është që të shërbejë si mekanizëm që inkurajon konsumatorin të racionalizojë shpenzimin e energjisë elektrike.

Meqë gjenerimi vendor nuk ka qenë i mjaftueshëm për mbulimin e kërkesës, gjatë vitit 2008 është importuar energji elektrike me vlerë prej 51.5 milionë euro. KEK SHA është subvencionuar me vlerë prej 42.8 milionë euro, të cilat zbriten nga të ardhurat e lejuara të KEK-ut, por që mungesa e tyre do të ndikonte në rritje të tarifës prej mesatarisht 18%.

Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) ka përfunduar rishikimin e tarifave të propozuara (1 prill 2008 - 31 mars 2009) në prill 2008. Megjithatë, vendimi mbi tarifat e rregulluara është marrë më 27 qershor 2008, kur Bordi i ZRRE-së është bërë funksional pas amendamentimit të Ligjit 2004/9.

Gjatë procesit të shqyrtimit tarifor, rëndësi e veçantë u është dhënë konsultimeve publike dhe shqyrtimit të komenteve të pranuar nga palët e interesuara. Dokumentet që kanë luajtur rol kyç në marrjen e vendimeve, komentet nga mbledhjet publike dhe diskutimet e drejtpërdrejta me palët e interesit, duke përfshirë këtu të licencuarit, përfaqësuesit e qeverisë dhe të parlamentit, si dhe konsumatorët janë publikuar në ueb-faqen e ZRRE-së.

Tarifat e zbatueshme nga data 1 qershor 2008 janë paraqitur në tabelën në vijim:

Grupi Tarifor	Niveli i tensionit të furnizimit	Elementet tarifore	Njësia	Koha gjatë ditës (a)	Aprovuar 2008			
					Sezona e lartë		Sezona e ulët	
					1 tetor - 31 mars		1 prill - 30 shtator	
0	110kV	Tarifa fiks e e konsumatorit	€/konsumator/vit		981.00			
		Fuqia e anqazhuar	€/kW		545.00	545.00		
		Energjia aktive (P), prej të cilës:	€/kWh	Tarifa e lartë	6.33	1.87		
			€/kWh	Tarifa e ulët	2.63	1.54		
		Energjia reaktive (Q); b)	€/kVArh		0.00	0.00		
1	35kV	Tarifa fiks e e konsumatorit	€/konsumator/vit		130.00			
		Fuqia e anqazhuar	€/kW		567.00	567.00		
		Energjia aktive (P), prej të cilës:	€/kWh	Tarifa e lartë	6.62	2.87		
			€/kWh	Tarifa e ulët	3.50	2.59		
		Energjia reaktive (Q); b)	€/kVArh		0.64	0.64		
2	10kV	Tarifa fiks e e konsumatorit	€/konsumator/vit		54.00			
		Fuqia e anqazhuar	€/kW		489.00	489.00		
		Energjia aktive (P), prej të cilës:	€/kWh	Tarifa e lartë	7.42	3.31		
			€/kWh	Tarifa e ulët	4.00	3.01		
		Energjia reaktive (Q); b)	€/kVArh		0.64	0.64		
3	0.4kV Kategoria I (konsumatorët e mëdhenj të energjisë reaktive)	Tarifa fiks e e konsumatorit	€/konsumator/vit		30.00			
		Fuqia e anqazhuar	€/kW		284.00	284.00		
		Energjia aktive (P), prej të cilës:	€/kWh	Tarifa e lartë	8.24	4.58		
			€/kWh	Tarifa e ulët	5.20	4.32		
		Energjia reaktive (Q); b)	€/kVArh		0.64	0.64		
4	0.4kV Kategoria II	Tarifa fiks e e konsumatorit	€/konsumator/vit		34.00			
		Fuqia e anqazhuar	€/kW		0.00	0.00		
		Energjia aktive (P)	€/kWh	Tarifa e vetme	10.16	6.57		
		Energjia aktive (P), prej të cilës:	€/kWh	Tarifa e lartë	12.22	8.01		
			€/kWh	Tarifa e ulët	6.11	4.00		
5	0.4kV matësi 2-tarifor (2-vlerësh, shtëpiak)	Tarifa fiks e e konsumatorit	€/konsumator/vit		24.00			
		Energjia aktive (P), për konsum:						
		<200kWh/muaj (Blloku i parë) prej të cilit:	€/kWh	Tarifa e lartë	4.53	3.25		
			€/kWh	Tarifa e ulët	2.27	1.62		
		200-600 kWh/muaj (Blloku i dytë) prej të cilit:	€/kWh	Tarifa e lartë	6.27	4.49		
			€/kWh	Tarifa e ulët	3.14	2.25		
>600 kWh/muaj (Blloku i tretë) prej të cilit:	€/kWh	Tarifa e lartë	9.10	6.52				
			€/kWh	Tarifa e ulët	4.55	3.27		
6	0.4kV matësi 1-tarifor (1-vlerësh, shtëpiak)	Tarifa fiks e e konsumatorit	€/konsumator/vit		24.00			
		Energjia aktive (P), për konsum:						
		<200kWh/muaj (Blloku i parë)	€/kWh	Tarifa e vetme	4.04	2.89		
		200-600 kWh/muaj (Blloku i dytë)	€/kWh	Tarifa e vetme	5.59	4.00		
		>600 kWh/muaj (Blloku i tretë)	€/kWh	Tarifa e vetme	8.11	5.81		
7	0.4kV (shtëpiak pa matës)	Konsumi i vlerësuar <200kWh/muaj	€/konsumator/muaj		21.00			
		Konsumi i vlerësuar 200-600kWh/muaj	€/konsumator/muaj		38.00			
		Konsumi i vlerësuar >600kWh/muaj	€/konsumator/muaj		64.00			
8	Ndrëimi publik	Tarifa fiks e e konsumatorit	€/konsumator/vit		34.00			
		Energjia Aktive (P), për konsum:	€/kWh	Tarifa e vetme	8.21	8.21		

- a) Tarifa e lartë aplikohet prej 07:00 - 22:00 gjatë sezonës së lartë dhe prej 08:00-23:00 gjatë sezonës së ulët
b) Konsumatori ngarkohet me energji reaktive të shpenzuar mbi atë të lejuar, $\cos \phi=0.95$

Tab.3.17 Tarifa me pakicë e miratuar nga ZRRE-ja

Tarifat e rregulluara me pakicë të konsumatorëve shtëpiakë, industrialë dhe komercialë janë rritur për 5% në krahasim me vitin 2007, me përjashtim të bllokut të parë me konsum nën 200 kWh, tarifa e të cilëve është rritur vetëm 2.5%. Megjithatë, Kosova vazhdon të mbesë njëra ndër vendet me tarifat më të ulëta të energjisë elektrike në rajon, siç shihet në grafikun në vijim:




Fig. 3.14 Tarifata mesatare të konsumatorëve shtëpiakë sipas shteteve

3.7.2 TARIFA NXITËSE (FEED-IN) PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA BURIMET E RIPËRTËRITSHME

Bazuar në legjislacionin primar, ZRRE-ja ka përcaktuar tarifën nxitëse (feed-in) për blerjen e energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e ripërtëritshme. Si palë nënshkruese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë, Kosova është e obliguar t'i përmbushë kushtet e direktivës 2001/77/EC në të cilin bazohet edhe Udhëzimi Administrativ 06/2007 i Ministrisë së Energjisë dhe Minerave "Mbi konsumin e energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e ripërtëritshme". Me këtë udhëzim janë përcaktuar caqet e sasisë së energjisë që duhet të konsumohet nga burimet e ripërtëritshme:

Tab.3.18 Caqet indikative për konsum të energjisë së prodhuar nga burimet e ripërtëritshme

Burimi i energjisë	Caqet indikative për konsum të energjisë së prodhuar nga burimet e ripërtëritshme (GWh)									
	2 007	2 008	2 009	2 010	2 011	2 012	2 013	2 014	2 015	2 016
Hidro	125.84	134.56	145.03	156.31	167.01	178.40	190.50	203.18	216.67	230.39
Erë	0.00	0.00	0.00	32.56	68.73	108.51	151.89	199.80	252.14	309.94
Solare	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Biomasë	0.00	0.00	0.00	0.00	11.63	17.45	19.77	23.26	29.08	29.08
Total	125.84	134.56	145.03	188.87	247.37	304.36	362.16	426.24	497.89	569.41

Qëllimi i tarifës feed-in është nxitja e investimeve në kapacitete të reja gjeneruese nga burimet e ripërtëritshme, në mënyrë që të mundësohet plotësimi i caqeve indikative të paraqitura në tabelën e mësipërme. Duke pasur parasysh parimet dhe kriteret bashkëkohore ekonomike, janë përcaktuar tarifata "feed-in" për blerjen e energjisë së prodhuar nga hidrocentralet e vogla dhe gjeneratorët e erës, të paraqitura në tabelat në vijim:

Tab.3.19 Tarifa e energjisë së prodhuar nga hidrocentralet e vogla

Kapaciteti i HCV	Çmimi (cent/kWh)
Hidrocentrale deri në 2MW	6.70
Hidrocentrale nga 2 MW deri në 5 MW	5.90
Hidrocentrale nga 5 MW deri në 10 MW	5.60

Tab.3.20 Tarifa e energjisë së prodhuar nga era

Tarifa nxitëse (Feed-in)	Çmimi (euro/MWh)
Të gjithë gjeneratorët me teknologji të re	84.00

4. SEKTORI I NGROHJES QENDRORE

4.1 PËRMBLEDHJE E ZHVILLIMEVE NË SEKTORIN E NGROHJES QENDRORE

Në vitin 2008, sektori i ngrohjes qendrore nuk ka shënuar zgjerim të dukshëm në raport me vitet e kaluara. Sektori i ngrohjes qendrore edhe më tutje mbetet mjaft i vogël në raport me kërkesat e parashikuara për ngrohje në Kosovë dhe plotëson afërsisht rreth 5% të kërkesës totale për ngrohje.

Sektori i ngrohjes qendrore është i kufizuar në katër kompani/ndërmarrje të ngrohjes qendrore, të cilat mbulojnë komunat e Prishtinës, Gjakovës, Mitrovicës dhe Zveçanit.

Zhvillim i rëndësishëm në sektorin e ngrohjes qendrore në Kosovë për kompletimin e bazës ligjore dhe rregullative të sektorit të ngrohjes qendrore në Kosovë është miratimi i Ligjit Nr. 03/L-116 për ngrohjen qendrore nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 20 nëntor 2008. Ligji për ngrohjen qendrore përcakton kushtet dhe standardet për kryerjen e aktivitetit të prodhimit, shpërndarjes dhe furnizimit me ngrohje, kushtet e operimit me stabilimente e objekte të tjera të ngrohjes qendrore, organizimin e tregut të ngrohjes dhe qasjen në rrjetin e shpërndarjes, si dhe të drejtat dhe detyrimet e subjekteve që veprojnë sipas këtij ligji.

Gjithashtu, Ligji për Ndërmarrjet Publike, i miratuar në qershor 2008, ka sjellë ndryshime sa i përket pronësisë, qeverisjes korporatave dhe mbikëqyrjes. Në fakt, me këtë ligj kompanitë e ngrohjes qendrore klasifikohen si ndërmarrje publike lokale dhe rrjedhimisht i kalojnë në pronësi dhe mbikëqyrje komunave respektive. Gjithnjë sipas këtij ligji, këto kompani organizohen si shoqëri aksionare, ku të drejtat e aksionare i ushtron Komisioni Komunal i Aksionarëve, ndërsa mbikëqyrja e veprimtarisë së kompanive bëhet nga Bordi i Drejtorëve, i cili zgjidhet nga Komisioni Komunal i Aksionarëve.

NQ "Termokos" dhe NQ "Gjakova" funksionojnë si korporata dhe janë ende në proces të implementimit të qeverisjes korporative sipas praktikave të njohura ndërkombëtare, si dhe të realizimit të objektivave për funksionim të suksesshëm në baza komerciale. Me gjithë zhvillimet pozitive në këtë drejtim, këto kompani ende nuk funksionojnë si biznese të vetëqëndrueshme dhe profitabile dhe, për pasojë, mbesin ende të varura nga subvencionet e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës.

Duhet theksuar se Ngrohtorja "Termomit" e Mitrovicës dhe Ngrohtorja e Zveçanit janë të organizuara si njësi punuese të ndërmarrjeve të integruara komunale të Mitrovicës respektivisht Zveçanit. Për shkak të rrethanave të njohura, këto ngrohtore nuk i përgjigjen kërkesave për rregullim dhe monitorim nga ZRRE-ja dhe, rrjedhimisht, pamundësohet sigurimi i të dhënave përkatëse të azhuruara.

PERFORMANSA E KOMPANIVE TË NGROHJES QENDRORE

Konsumi i lëndëve djegëse dhe gjenerimi i ngrohjes

Gjenerimi i ngrohjes bëhet në ngrohtoret e qyteteve të pajisura me kaldaja, që kryesisht si lëndë djegëse përdorin naftën e rëndë (mazutin) dhe në masë të vogël naftën e lehtë për djegie (dizelin), që importohen me çmime të bursës plus "premiumi" për mbulimin e shpenzimeve të furnizuesit. Për këtë, çmimi i mazutit ndikohet shumë nga lëvizjet e çmimit në tregjet ndërkombëtare; lëvizje këto që në periudhën e sezonit të ngrohjes 2007/2008 kanë qenë shumë të mëdha, duke shënuar rritje shumë të madhe, e cila ka ndikuar në shtimin e kostos së lëndës djegëse dhe, rrjedhimisht, në rritjen e kostos së gjenerimit të ngrohjes qendrore.

Çmimi i naftës së papërpunuar në fillimin e sezonit 2007/2008 ka qenë përafërsisht 80 \$/barel në mes të muajit tetor 2007, për të arritur në përafërsisht 110 \$/barel në përmbyllje të këtij sezoni, gjë që ka ndikuar po ashtu në ngritjen e çmimit të mazutit, i cili ka qenë rreth 230 cent/galon në mes të muajit tetor 2007 dhe ka arritur vlerën deri në 330 cent/galon në mesin e muajit prill 2008

Më poshtë është paraqitur në formë tabelore sasia e konsumit të lëndëve djegëse dhe çmimet mesatare të blerjes së tyre gjatë sezonit të ngrohjes qendrore 2007/2008, sipas të dhënave të raportuara nga kompanitë e ngrohjes qendrore.

Tab. 4.1: Konsumi i derivateve dhe çmimi mesatar blerës për sezonin 2007/2008

Kompania -Sistemi i NQ-së	Mazuti		Nafta (Dizeli)	
	Konsumi (ton)	Çmimi mesatar i blerjes (€/ton)	Konsumi (ton)	Çmimi mesatar i blerjes (€/ton)
TERMOKOS - Prishtina	9,336.00	358.92	43.64	864.69
NQ GJAKOVA	1,757	355	NA	NA
Totali i Sektorit të NQ	11,093.45	356.74	43.64	864.69

NA – Nuk aplikohet (ose nuk është në dispozicion)

Kapacitetet e impianteve të gjenerimit të ngrohjes dhe të dhënat e prodhimit e furnizimit janë paraqitur në tabelën 4.2.

Shpërndarja e ngrohjes

Karakteristikë e përbashkët e të gjitha sistemeve të ngrohjes qendrore në Kosovë është se rrjeti i tyre i shpërndarjes përbëhet nga rrjeti primar që shtrihet deri në pikën e furnizimit në nënstacione dhe nga rrjeti sekondar, i cili shtrihet nga pika e furnizimit në nënstacione deri te shfrytëzuesit përfundimtarë.

Rrjeti primar i shpërndarjes të ngrohjes i KNQ “Termokosi” ka një gjatësi prej afërsisht 29 km, me kapacitet rreth 300 MW dhe është i mbidimensionuar në raport me kapacitetet prodhuese të KNQ “Termokos”. Pjesë integrale e rrjetit të shpërndarjes është edhe stacioni i pompimit dhe shkëmbyesve të nxehtësisë, i cili gjendet në Kodrën e Diellit dhe 255 nënstacione, të cilat janë pika ndarëse ndërmjet rrjetit primar dhe atij sekondar.

Rrjeti primar i shpërndarjes i KNQ “Gjakova” shtrihet në gjatësi prej rreth 20 km. Katër (4) km nga totali i rrjetit është rrjet i ri i gypave i realizuar në vitin 2001. Gjatë vitit 2007/2008 është zgjeruar rrjeti për afërsisht 4 km. Pjesë përbërëse e këtij rrjeti janë edhe rreth 180 nënstacione të cilat janë pika ndarëse ndërmjet rrjetit primar dhe sekondar. Njehsorët e energjisë termike janë instaluar në 42 nënstacione.

Një përmbledhje e karakteristikave teknike të sistemeve të ngrohjes qendrore, si dhe e të dhënave të gjenerimit dhe furnizimit, paraqiten në tabelën më poshtë.

Tab.4.2: Karakteristikat teknike të sistemeve të ngrohjes qendrore

Kompania (Qyteti)	Kapaciteti i instaluar [MW]	Kapaciteti operacional [MW]	Rrjeti i shpërndarjes		Gjenerimi i ngrohjes, sezoni 2007/08 [MWh/vit]	Furnizimi me ngrohje në NS të konsumatorëve, sezoni 2007/08 [MWh/vit]
			Gjatësia e rrjetit [km]	Nr. i nënst.		
TERMOKOS - (Prishtinë)	2 x 58 = 116	2 x 58 = 116				
	1 x 29 = 29	2 x 7 = 14	29	255	93,423	73,161
	2 x 7 = 14	1 x 4 = 4				
	1 x 4 = 4					
Nën-total	163	134	29	255	93,423	73,161
NQ GJAKOVA	1 x 20 = 20	1 x 20 = 20	20	180	14,894	11,031
	1 x 18.6 = 18.6					
Nën-total	38.60	20	20	180	14,894	11,032
Total	201.6	172.5	49.00	435	108,317	84,193

NA – Nuk aplikohet (ose nuk është në dispozicion)

4.3 ÇËSHTJET LIDHUR ME KONSUMATORËT

Shërbimi i furnizimit

Në sezonin 2007/2008, sipërfaqja totale e shërbimit të furnizimit me ngrohje e mbuluar nga “Termokosi”, për të dy grupet e konsumatorëve, është 1,024,496 m², që paraqet një rritje mjaft të vogël prej 15,554 m² nga sezoni i kaluar. Në këtë sipërfaqe totale grupi i konsumatorëve shtëpiakë merr pjesë me 632,602 m² ndërsa grupi i konsumatorëve komercialë e institucionalë me 391,867 m², gjegjësisht proporcioni ndërmjet dy grupeve të konsumatorëve është 61.75% - 38.25%. “Termokosi” në përgjithësi furnizon përafërsisht 12,100 konsumatorë: 11,540 amvisëri dhe 560 konsumatorë komercialë e institucionalë.

Sipërfaqja totale e shërbimit të furnizimit me ngrohje e NQ “Gjakova” në sezonin 2007/2008 është rreth 131,700 m², që është një rritje e vogël prej 4,000 m² nga sezoni i kaluar; pjesëmarrja e konsumatorëve shtëpiakë është 69,443 m² ndërsa e atyre komercialë e institucionalë është 61,861 m², gjegjësisht në proporcion 52.89% - 47.11 %.

Faturimi dhe arkëtimi

Realizimi i objektivave të ndërlidhura me faturimin efikas dhe rritjen e arkëtimit paraqet problem serioz, që edhe në 2008 nuk shënon përmirësim të dukshëm nga viti paraprak.

Faturimi ende kryhet sipas sipërfaqes së paravlerësuar ngrohëse të secilit konsumator (për metër katror) për shkak të mungesës së implementimit të njehsimit (matjes) të ngrohjes së furnizuar. Sa i përket faturimit janë vërejtur vështirësi në kuptim të mosarritjes së nivelit të planifikuar të faturimit për shkak të zbritjes në fatura të ditëve pa ngrohje të shkaktuara nga prishjet e sistemit (ngrohtorja, rrjeti) dhe mungesa e lëndës djegëse, si dhe për shkak të ngrohjes së pamjaftueshme si pasojë e rrjedhjeve të ujit të ngrohtë në sistemin e shpërndarjes. Ndikim në mosarritjen e nivelit adekuat të faturimit ka edhe mosazhurnimi dhe saktësia e pamjaftueshme e bazës së të dhënave të konsumatorëve.

Shkalla mesatare e arkëtimit të pagesave për sektorin e ngrohjes qendrore vlerësohet të jetë mjaft e ulët, rreth 38 % për sezonin 2007/2008, e cila paraqet një zvogëlim për 1.5 % në krahasim me sezonin 2006/2007.

Arkëtimi i ulët i pagesave është i shkaktuar nga një varg faktorësh të ndryshëm. Disa nga këta faktorë janë drejtpërdrejtë të ndërlidhur me kompanitë e ngrohjes qendrore, siç janë: performansa jo e

kënaqshme e gjenerimit dhe furnizimit, shërbimi i dobët ndaj konsumatorëve dhe joefikasiteti në faturim dhe arkëtim. Faktorët tjerë ndërlidhen me situatën e përgjithshme ekonomike dhe të ardhurat e popullsisë, siç janë: mundësia dhe vullneti për të paguar, mungesa e administrimit banesor dhe masat e pamjaftueshme ligjore për trajtimin e çështjes së mospagesës nga konsumatorët.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të dhënat për sipërfaqet ngrohëse, tarifat, faturimin dhe arkëtimin për kompanitë respektive të ngrohjes qendrore për sezonin 2007/2008.

Tab. 4.3 Shkalla e arkëtimit në kompanitë e NQ-ve në Kosovë për sezonin 2007/08

Sezoni i ngrohjes 2007/2008	Sip. ngrohëse [m ²]	Tarifa [€/m ²]	Faturimi (përf. TVSH) [€]	Arkëtimi [€]	Shkalla e arkëtimit [%]
NQ "Termokos" Prishtina					
Amvisëri	632,602	0.79	2,046,509	264,279	12.91
Komercial e Institut.	391,867	0.95	1,762,141	1,126,011	63.90
Total	1,024,469		3,808,650	1,390,290	36.50
NQ "Gjakova"					
Amvisëri	69,443	0.85	261,478	62,413	23.87
Komercial e Institut.	61,861	1.23	388,271	193,917	49.94
Total	131,304	-	649,749	256,330	39.45

4.4 SHQYRTIMI I ÇMIMEVE TË NGROHJES QENDRORE PËR SEZONIN E NGROHJES 2007/2008

Korniza ligjore dhe rregullative për shqyrtimin e çmimeve të ngrohjes qendrore

Siç përcaktohet në kapitullin 9 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, ZRRE-ja ka kompetencë dhe përgjegjësi për krijimin e metodologjisë tarifore dhe miratimin e tarifave në sektorin e rregulluar të energjisë

Sektori i ngrohjes qendrore në Kosovë në transportimin dhe në shpërndarjen e ngrohjes klasifikohet si monopol natyror, përderisa në gjenerimin e ngrohjes dhe furnizimin e ngrohjes ende nuk ekziston ndonjë konkurrencë. Prandaj, tarifat e ngrohjes qendrore i nënshtrohen miratimit nga ZRRE-ja.

Në përputhje me obligimet ligjore dhe kompetencat e saj, ZRRE-ja më 10 qershor 2008 shpalli fillimin e shqyrtimit të çmimeve të ngrohjes qendrore për sezonin e ngrohjes 2008/2009, duke pasur qëllim kryesor vlerësimin real të informatave financiare dhe teknike të dorëzuar nga KNQ-të, në mënyrë që tarifat e ngrohjes qendrore të reflektojnë kostot reale.

Në lidhje me këtë ZRRE-ja ka nxjerrë dy udhëzime:

- Udhëzimi i Përkohshëm I_06_2008 për Raportimin Rregullativ të Ndërmarrjeve të Ngrhjes Qendrore
- Udhëzimi i Përkohshëm I_07_2008 për Parimet e Llogaritjes së Tarifave dhe Çmimeve në Sektorin e Ngrhjes Qendrore në Kosovë për Sezonin e Ngrhjes 2008/2009.

Metodologjia tarifore

Për formulimin/llogaritjen e tarifave dhe çmimeve është zbatuar metodologjia e Normës së Kthimit (RoR) ose e ashtuquajtura kosto plus.

Metodologjia RoR definon koston e lejuar, e cila duhet të rikthehet dhe profitin e arsyeshëm, i cili duhet të fitohet nga KNQ-ja, profit që është llogaritur sipas Normës së Lejuar të Kthimit (RoR) mbi Bazën e Rregulluar të Aseteve (RAB).

Procesi i shqyrtimit të çmimeve

ZRRE-ja ka filluar shqyrtimin e çmimeve, duke nxjerrë dhe publikuar udhëzimet dhe dokumentet tjera relevante. Për më tepër janë mbajtur takime informuese dhe janë bërë ndërveprime të tjera me KNQ-të dhe palët e interesuara të involvuara në sektorin e ngrohjes qendrore, me qëllim që të shpjegohen dhe të sqarohen udhëzimet dhe aspektet kryesore të procesit të shqyrtimit të çmimeve.

Në përputhje me procedurat e parapara në udhëzimet e lartpërmendura, procesi i shqyrtimit të çmimeve filloi me dorëzimin në ZRRE të raporteve rregullative, e pasuar me aplikacionin për tarifa nga kompanitë e ngrohjes qendrore.

Procesi i shqyrtimit të çmimeve për sezonin 2008/09 ka përfshirë këto faza kryesore:

- Bashkërendimin e të ardhurave të lejuara, bazuar në ndryshimin e të ardhurave të projektuara për sezonin paraprak të ngrohjes (2007/2008) dhe të ardhurave të lejuara që faktikisht janë realizuar në këtë sezon;
- Përcaktimin e të ardhurave të lejuara për sezonin e ngrohjes 2008/09 në bazë të informatave dhe të dhënave të parashikuara në aplikacionin për tarifa dhe të verifikuara dhe të konsideruara të arsyeshme nga ZRRE-ja;
- Llogaritjen e tarifave bazuar në të ardhurat e lejuara dhe në propozimin për tarifa të cilat iu nënshtruan miratimit përfundimtar nga ZRRE-ja.

Si rrjedhojë e fazave të lartpërmendura, ZRRE-ja nxori këto dokumente:

- Bashkërendimin për KNQ-të “Termokos” dhe “Gjakova”, të shoqëruara me raporte rregullative gjithëpërfshirëse për secilën KNQ, të cilat janë dhënë si shtojca të përcaktimit të bashkërendimit;
- Vendimet për miratimin e të ardhurave të lejuara për KNQ “Termokos” dhe KNQ “Gjakova” (V_132_2008 dhe V_133_2008), të shoqëruar me raport rregullativ gjithëpërfshirës e të hollësishëm në formë të shtojcës respektive të vendimit për të ardhurat e lejuara.

Duhet të theksohet se përcaktimi i të ardhurave të lejuara ka qenë bazë e llogaritjes përfundimtare të tarifave dhe dorëzimit të propozimit për tarifa nga kompanitë e ngrohjes qendrore, për miratim final nga ZRRE-ja.

Vendimet e ZRRE-së për miratimin e normave tarifore për KNQ “Termokos” dhe KNQ “Gjakova” (V_134_2008 dhe V_135_2008) të shoqëruara me shtojcat përkatëse shënojnë përfundimin e procesit të shqyrtimit të çmimeve të ngrohjes qendrore për sezonin 2008/2009.

Tab. 4.4 Përmbledhje e tarifave për kompanitë e ngrohjes qendrore – sezoni i ngrohjes 2008/2009

A. Tarifat e ngrohjes për konsumatorët pa matje

KOMPANITË NQ	Komponentët e tarifave	Konsumatorët shtëpiakë [€ / m2 për muaj]	Konsumatorët komercialë e institucionalë [€ / m2 për muaj]
NQ TERMOKOS SHA	Kapaciteti i ngrohjes i kontraktuar (komp. fikse)	0.06	0.08
	Ngrohja e furnizuar (komp. variabël)	0.78	0.92
NQ GJAKOVA SHA	Kapaciteti i ngrohjes i kontraktuar (komp. fikse)	0.13	0.17
	Ngrohja e furnizuar (komp. variabël)	0.77	1.11

B. Tarifat e ngrohjes për konsumatorët me matje

KOMPANITË NQ	Komponentët e tarifave	Njësia matëse	Çmimi
NQ TERMOKOS SHA	Kapaciteti i ngrohjes i kontraktuar (komp. fikse)	€ / kW për muaj	0.59
	Ngrohja e furnizuar (komp. variabël)	€ / MWh	45.50
NQ GJAKOVA SHA	Kapaciteti i ngrohjes i kontraktuar (komp. fikse)	€ / kW për muaj	1.33
	Ngrohja e furnizuar (komp. variabël)	€ / MWh	47.62

Përcjellja e implementimit të tarifave për sezonin 2008/2009

ZRRE-ja në vazhdimësi monitoron për së afërmi implementimin e tarifave përmes kontakteve dhe mbledhjeve të rregullta me KNQ-të. Aspektet kryesore të monitorimit janë: realizimi i faturimit të planifikuar, arkëtimi i pagesave të konsumatorëve, ndikimi i tarifave në shkallën e arkëtimit, si dhe sasia dhe cilësia e ngrohjes së furnizuar.

Synim i vazhdueshëm është që KNQ-të të kalojnë nga “tarifa normative” në “tarifën e energjisë së konsumuar” sa më shumë që është e mundur, duke potencuar se “tarifa e energjisë së konsumuar” e bazuar në konsumin real të matur të ngrohjes është në favor të nxitjes së konsumatorëve për ruajtjen e ngrohjes dhe përdorimit sipas nevojave të tyre, si dhe të faturimit real, d.m.th. konsumatorit i faturohet vetëm energjia e cila është konsumuar, gjë e cila mund të rrisë shkallën e arkëtimit. Për më tepër, implementimi i “tarifës së energjisë së konsumuar” është një kërkesë ligjore që del nga Ligji për Ngrahjen Qendrore.

5. MBROJTJA E KONSUMATORËVE

5.1 HYRJE – BAZA LIGJORE

Zyrës së Rregullatorit për Energji i është dhënë mandati ligjor që të merret me mbrojtjen e konsumatorëve dhe zgjidhjen e kontesteve në sektorin e energjisë në Kosovë (Neni 15.2 g i Ligjit për Rregullatorin e Energjisë).

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE është përgjegjës për sigurimin e aplikimit të legjislacionit për mbrojtjen e konsumatorëve në sektorin e energjisë në Kosovë.

Në këtë vit raportues ZRRE përmes Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve (DMK) ka proceduar shumë ankesa të konsumatorëve, si dhe një ankesë të një të licencuari kundër një të licencuari tjetër. Shumica e ankesave të konsumatorëve kanë qenë kundër vendimeve/përgjigjeve të lëshuara nga KEK-u dhe natyra e tyre ka qenë kundërshtim për faturat që iu janë ngarkuar konsumatorëve për shfrytëzim të paligjshëm të energjisë.

KEK-u si ndërmarrje vertikalisht e integruar ende nuk ka arritur që të vendosë një sistem të qëndrueshëm dhe efikas për zgjidhjen e kontesteve të konsumatorëve. Në proceset dhe vendimet/përgjigjet e përgatitura nga stafi i KEK-ut ka shumë dobësi, kundërshtime, mungesë të respektimit të procedurave si dhe mosnjohje të rregullave dhe ligjeve në fuqi, e gjithashtu u mungon analiza për secilin rast të veçantë. Si pasojë e këtyre dobësive kemi një numër shumë të madh të konsumatorëve të cilët kundërshtojnë veprimet e ndërmarrja nga KEK-u në DMK të ZRRE-së.

Problem në veçanti që duhet të theksohet për vitin raportues është numri enorm i proceseve që ekipet e KEK-ut kanë përgatitur për shfrytëzim të paligjshëm të energjisë e posaçërisht proceset në lidhje me abuzimet e njehsorëve.

Shumica e konsumatorëve të cilët janë ngarkuar nga KEK-u me faturë për shfrytëzim të paligjshëm të energjisë elektrike dhe të cilët pas parashtrimit të ankesës së tyre në KEK kanë marrë përgjigje nga KEK-u kanë parashtruar ankesë në DMK të ZRRE-së.

5.2 ANKESAT DHE AKTIVITETET NË ZGJIDHJEN E KONTESTEVE

Gjatë vitit 2008, Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve (DMK) në Zyrën e Rregullatorit për Energji ka regjistruar në regjistrin e ankesave gjithsej 572 ankesa të konsumatorëve. Në tabelën 5.1 është paraqitur regjistrimi dhe zgjidhja e ankesave të konsumatorëve.

Tab.5.1 Numri i ankesave të regjistruara dhe të zgjidhura në DMK të ZRRE-së

Ankesat Gjithsej	
Të regjistruara	Të zgjidhura
572	107

Numri më i madh i ankesave të konsumatorëve të regjistruar në regjistrin e DMK-së ka ndodhur kryesisht gjatë muajve të verës, kur KEK-u ka ndërmarrë një aksion të madh rreth shkyçjes së konsumatorëve nga rrjeti elektrik për shkak të borxhit të energjisë elektrike. Aksioni i KEK-ut i ndërmarrë gjatë verës për shkyçjen e konsumatorëve nga rrjeti elektrik ka ndodhur pas aprovimit të Urdhëresës për shkyçje nga Qeveria e Kosovës me numër Vendimi 06/29 të datës 31.07.2008. Kjo Urdhëresë e aprovuar nga Qeveria e Kosovës ka pezulluar të gjitha dispozitat e Rregullës mbi shkyçjen dhe rikyçjen e konsumatorëve në sektorin e energjisë të nxjerrë nga ZRRE-ja më 24 shkurt 2006, të cilat janë në kundërshtim me këtë urdhëresë. ZRRE nuk është pajtuar me këtë urdhëresë, pasi që kjo ka shkaktuar shumë probleme në punën e ZRRE-së lidhur me ankesat e konsumatorëve.

Vlen të theksohet se DMK në vitin 2008 ka trashëguar 54 ankesa të pazgjidhura nga viti 2007.

Në regjistrin e ankesave të konsumatorëve në DMK të ZRRE-së janë të regjistruar ankesa të natyrave të ndryshme: shfrytëzim i paautorizuar, regjistrim i pasaktë i energjisë nga njehsorët digjitalë, faturimi pa matje ("afofe"), gjobat për shkycje, parapagimi për RTK, bartja e borxhit etj.

Tab. 5.2 Ankesat e konsumatorëve sipas natyrës së tyre

Shfrytëzim i paautorizuar	Të tjera
486	86

Gjatë vitit 2008 nga të gjitha ankesat e konsumatorëve të regjistruar në regjistrin e DMK të ZRRE-së, 85 % prej tyre kanë qenë për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike, ndërsa vetëm 15 % të tyre kanë qenë të natyrave të ndryshme.

Sipas grupeve të konsumatorëve, në DMK janë regjistruar këto ankesa:

- 461 ankesa të konsumatorëve kanë qenë shtëpiakë;
- 104 ankesa të konsumatorëve kanë qenë komercialë;
- 7 ankesa të konsumatorëve kanë qenë industrialë;

Tab.5.3. Ankesat e konsumatorëve sipas kategorive të konsumatorëve

Shtëpiakë	Komercial	Industrial
461	104	7

Nga Tab. 5.3 shihet qartë se shumica e ankesave të konsumatorëve, të cilët kanë parashtruar ankesë në DMK të ZRRE-së, kanë qenë konsumatorët shtëpiakë (81%), konsumatorët komercialë (18 %) dhe konsumatorët industrialë (1%).

Për të pasqyruar rritjen e numrit të ankesave të parashtruara në DMK gjatë vitit 2008, në tab.5.4 është paraqitur numri i ankesave për vitin 2006, 2007 dhe 2008.

Tab.5.4 Krahasimi i ankesave të konsumatorëve - 2006, 2007 dhe 2008

Periudha	Viti 2006	Viti 2007	Viti 2008
Gjithsejt	33	116	572

6. PERSPEKTIVA E SEKTORIT TË GAZIT NATYROR NË KOSOVË

Përkundër faktit se në Kosovë nuk është prezent gazi natyror, legjislacioni i energjisë i Kosovës e definojnë gazin natyror si pjesë përbërëse të sektorit të energjisë së Kosovës. Ligji për Energjinë e definojnë termin "energji" si "çdo formë e energjisë së prodhuar ose e siguruar (elektricitet, ngrohje ose gaz natyror) me qëllim të furnizimit ose shitjes", ndërsa sipas kapitullit 3, neni 17, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, kompetencat e ZRRE-së shtrihen edhe në sektorin e gazit natyror. Me qëllim të kompletimit të kornizës ligjore, MEM ka hartuar Projektligjin për gazin natyror, i cili në dhjetor 2008 është paraqitur në Kuvendin e Republikës së Kosovës për procedurën e miratimit. Për më tepër, në "Strategjinë e Sektorit të Energjisë së Kosovës 2007 – 2013" një ndër objektivat strategjike është lidhja e Kosovës me gazsjellësit rajonalë deri në fund të vitit 2012. Po ashtu, në draft dokumentin "Politikat afatmesme zhvillimore të sektorit të energjisë" furnizimi me gaz në Kosovë në të ardhmen shikohet si mundësi reale, bazuar në studimin e gazifikimit të Evropës Juglindore, i cili ka shqyrtuar mundësinë ekonomike të hyrjes së gazit natyror në Kosovë si pjesë e propozimit të "Unazës së gazit të Komunitetit të energjisë" (Figura 6.1), e cila lidh shtatë vende të Evropës Juglindore dhe ka konkluduar se furnizimi i konsumit industrial dhe komercial do të ishte i realizueshëm (fizibël) si dhe ndërtimi i rrjetit të shpërndarjes së gazit në Prishtinë dhe Mitrovicë. Në këtë kontekst parashihen në varg masash për të qartësuar pronësinë e rrjetit të vjetër të gazit artificial nga linjiti (TC Kosova A – Prishtinë – Mitrovicë – Shkup – Ferronikel – Lamkos – Amortizerët, në gjatësi të përgjithshme prej 254 km), si dhe të drejtën për shfrytëzimit të kësaj traseje.



Fig.6.1 Koncepti i "Unazës së gazit të Komunitetit të energjisë" (Burimi: Studimi i gazifikimit të rajonit të Evropës Juglindore)

Prezenca e gazit natyror në dokumentet bazë të sektorit të energjisë në Kosovë kryesisht vjen për shkak të pozitës gjeostrategjike të vendit tonë, si një vend në qendër të rajonit të Evropës

Juglindore, rajon ky përmes së cilit parashihen të kalojnë linjat e gazsjellësve që ndërlidhin burimet e gazit natyror në rajonin e Kaspikut dhe në Rusi me shtete zhvilluara të Evropës Perëndimore - siç paraqitet në projektet e planifikuara të akseve prioritare të gazsjellësve (Figura 6.2).




Fig. 6.2 Projektet e planifikuara të akseve prioritare të gazsjellësve (Burimi: Studimi i gazifikimit të rajonit të Evropës Juglindore)

Në vijim të plotësimit të përgjegjësiave ligjore për zhvillimin e kornizës ligjore dhe obligimeve karshi Traktatit të Komunitetit të Energjisë së Evropës Juglindore, gjatë vitit 2008 ZRRE ka qenë aktive dhe ka përcjellë zhvillimet rajonale lidhur me sektorin e gazit natyror dhe punën e Grupit punues të gazit në kuadër të Bordit Rregullativ të Komunitetit të Energjisë, organizëm ky i Traktatit të Komunitetit të Energjisë. Në këtë aspekt, ndër tjera, ZRRE ka kontribuar me komentet, vërejtjet dhe sugjerimet e veta në finalizimin e dokumenteve: "Raporti për implementimin e 'asquis' për elektricitet dhe gaz natyror të Traktatit për themelimin e Komunitetit të energjisë" dhe "Studimin për përmirësimin e ndërlidhjeve, ndërfunksionimit, transparencës dhe harmonizimit të rregullave operacionale për transportimin e gazit natyror në Komunitetin e energjisë".

7. BASHKËPUNIMI I ZRRE-së ME INSTITUCIONET E TJERA DHE AKTIVITETI NDËRKOMBËTAR

Bashkëpunimi i Zyrës me institucionet qeveritare dhe parlamentare

Gjatë vitit 2008 Zyra ka pasur bashkëpunim të frytshëm me institucionet parlamentare, ato qeveritare, si dhe me ndërmarrjet energjetike. Me ftesë të komisioneve të Parlamentit të Republikës së Kosovës, përkatësisht të Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, Zyra ka raportuar për një varg çështjesh si: Tarifat për vitin 2008, Shqyrtimi i Raportit të Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin 2007, Buxheti i ZRRE-së për vitin 2009, etj.

Zyra po ashtu ka bashkëpunuar dhe diskutuar me ministritë përkatëse për tarifrat, përballeshmërinë e pagesës së konsumatorëve në nevojë, subvencionet e qeverisë dhënë KEK-ut për këtë grup konsumatorësh, etj. Zyra ka organizuar disa punëtori në MEM në temat: “Zhvillimet e Vendosijes së Tarifave të Kostove Refleksive të Energjisë Elektrike” dhe draftversioni i fundit i “Rregullës së autorizimit”.

Përfaqësuesit e Zyrës kanë marrë pjesë rregullisht në takimet dhe punëtoritë e sektorit të energjisë të organizuara nga qeveria. Një bashkëpunim i veçantë ndërinstitucional është zhvilluar ndërmjet MEM-it, ZRRE-së, KOSTT-it dhe KEK-ut, në përmbushjen e obligimeve që dalin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë, si dhe në dërgimin e të dhënave të kërkuara nga trupat e TKE të EJJ, pjesa për Kosovën.

Zyra ka përfaqësues në grupet punuese vijuese:

Grupi Punues për Integritet Evropian, vepron në MEM, në kuadër të një aktiviteti më të gjerë të **Grupit Punues për Infrastrukturë** dhe të Agjencisë për Koordinimin e Zhvillimit dhe Integritet Evropian. Agjencia është e vendosur me një vendim të veçantë të Kryeministrit të Republikës së Kosovës. GP ka për obligim zbatimin dhe monitorimin e veprimeve të paraqitura në “Planin e Veprimit për Partneritet Evropian”. Zyra ka zhvilluar aktivitete për përmbushjen e obligimeve në fushën e përgjegjësive të saj, që dalin nga “Plani i Veprimeve për Partneritet Evropian” dhe nga “Raportit i Progresit 2008” për Kosovën, publikuar nga Komisioni Evropian.

Grupi Punues për Përgatitjen e Planit të Veprimit për Çështje Sociale vepron në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Grupi Punues për Përgatitjen e Standardeve të Kualitetit të Furnizimit dhe Shërbimit përbëhet nga përfaqësuesit e palëve të interesit në sektorin e energjisë dhe udhëhiqet nga ZRRE-ja.

Zyra ka marrë pjesë aktive në takimet e punës në punëtori, seminare të organizuara edhe nga palët e ndryshme në kuadër të sektorit të energjisë së Kosovës.

Aktiviteti ndërkombëtar i Zyrës

Gjatë vitit 2008 Zyra ka zhvilluar një seri aktivitete ndërkombëtare në fushën rregullative në kuadër të TKE- së dhe në asociacionet tjera rajonale dhe ndërkombëtare.

ZRRE-ja dhe Traktatit i Energjisë i Europës Juglindore

ZRRE gjatë vitit 2008 ka pasur aktivitete në kuadër të Traktatit të Komunitetit të Energjisë për Evropën Juglindore, në organe dhe grupe të ndryshme punuese.




Fig.7.1 Grupet punuese brenda Bordit Rregullativ të Traktatit të Energjisë për Evropën Juglindore

Sekretariati i Traktatit të Komunitetit të Energjisë është i vendosur në Vjenë dhe ofron përkrahje administrative institucioneve të komunitetit, siç janë: Këshilli Ministror, Grupi i Përhershëm i Nivelit të Lartë dhe Bordi i Rregullatorëve.

Bordi Rregullativ i Komunitetit të Energjisë (BRKE) i ka grupet punuese në sektor të energjisë elektrike, të gazit dhe grupit për konsumatorë. Në çdo grup punues, po ashtu edhe në BRKE, ZRRE-ja ka të emëruar anëtarët e vet. Vet BRKE vepron në Athinë, ndërsa grupet punuese takimet i mbajnë në shtetet që janë nënshkruese të TKE të EJL. Sipas Programit të Punës, në vitin 2008 aktivitetet kryesore të BRKE kanë qenë në sektorët e:

- **Energjisë elektrike:** Menaxhimi i kongjestionit dhe alokimi i kapaciteteve; Mekanizmi rajonal balancues; Pajtueshmëria e rregullave të tregut; Hapja e tregut me shumicë; Njohja reciproke e licencave; Bashkëpunimi ndërkufitar; Zyra e aukcionit të koordinuar; etj.
- **Gazit:** Tregtimi ndërkufitar me gaz; Ndërlidhja dhe ofrimi i linjave gypore të gazit për transit dhe bartje; Balancimi, përfshirë këtu edhe terminalet e gazit natyror të lëngët; Bashkëpunimi ndërkufitar dhe tarifatat e transmisionit, etj;
- **Konsumatorëve:** Kualiteti i furnizimit dhe i shërbimeve komerciale; Standardet dhe nxitjet; Metodologjia e tarifave dhe transparenca e çmimeve; Analiza e zbatimit të praktikave më të mira në mbrojtjen e konsumatorëve në nevojë, në shtetet anëtarë të TKEEJL, etj.

BRKE ka vazhduar rolin këshillëdhënës për Këshillin Ministror të TKEEJL-it në çështje të monitorimit dhe qasjes së punës të sistemit elektroenergjetik dhe tregut rajonal. Gjithashtu, ka dhënë sugjerime për funksionim e rregullt të tregut rajonal, aktivitetet për një treg të përbashkët të energjisë elektrike dhe gazit, hapje të mëtutjeshme të tregut, njohje reciproke të licencave në rajon, marrje të një qëndrimi në lidhje me balancimin rajonal, krijimi i zyrës për aukcion për rajonin e Evropës Juglindore.

Gjatë vitit 2008 ka nisur studimi “Raport mbi Zhvillimet e Tregut të Energjisë Elektrike” në rajonin e EJL, që realizohet nga konsulencia e mbështetur nga “USAID” SHBA dhe pritet që do të vazhdojë edhe në vitin 2009. Ky raport trajton në mënyrë të pabarabartë Operatorin e Transmisionit të Kosovës, veçanërisht në raport me Operatorin e Transmisionit të Serbisë. Zyra e Rregullatorit për Energi e

Republikës së Kosovës nuk është pajtuar me një trajtim të këtillë dhe në mënyrë të vendosur ka kundërshtuar aprovimin e tij, duke dhënë komente, në të gjitha fazat e draftimit të tij.

Edhe gjatë vitit 2008 kanë mbetur të pazgjidhura problemet ndërmjet KOSTT-t dhe Operatorit të Transmisionit të Serbisë në fushën e transimit, alokimit të kapaciteteve bartëse të linjave interkonektive si dhe mosnjohja e KOSTT-it në marrëveshjen për mekanizmin e kompensimit ndërmjet Operatorëve të Transmisioneve Rajonale.

Lidhur me këtë vlen të përmendet se KOSTT ka iniciuar procedurën për zgjidhjen e këtij kontesti, ndërmjet Operatorit të Sistemit të Transmisionit të Kosovës dhe atij të Serbisë, në Sekretariatit e TKE të EJL me seli në Vjenë dhe është në procedurë të mëtejme.

Raporti “Zhvillimet e Tregut të Energjisë Elektrike” ka si objekt kryesor të studimit monitorimin e tregut të energjisë në Evropën Juglindore dhe monitorim në vazhdimësi të tregut me shumicë të energjisë elektrike, në pajtim me përfundimet e Forumit të 12-të të Athinës. Ai i dedikohet monitorimit të zhvillimit të mekanizmave koordinuese të aukcionit dhe zbatimit të funksioneve monitoruese për Zyrën e Aukcionit të Koordinuar dhe për Aukcionin e koordinuar. Kjo zyrë do të përfshijë shtetet e Rajonit të tetë.

Rajoni i tetë është përkufizuar nga Këshilli Ministror i TKE, në takimin e Brukselit të datës 27 qershor 2008, në formë të amendamentimit të Aneksit të Rregullores (EC) nr. 1228/2004 për kushtet e qasjes në rrjet të shkëmbimeve ndërkufitare të energjisë. Territorët e shteteve të Rajonit të 8-të janë: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Mali i Zi, Rumania, Serbia, UNMIK (Kosova), Greqia, Sllovenia dhe Italia në pajtim me lidhjet e interkoneksionit me palët aderuese të TKEEJL. Në këtë takim është vendosur që shtetet e mësipërme duhet të zbatojnë jo më larg se deri më 31 dhjetor të 2009-ës metodën e menaxhimit të koordinuar të kongestionit si dhe procedurat e alokimit të kapaciteteve në treg, së paku në bazë vjetore, mujore dhe ditore.




Fig. 7.2 Shtetet anëtare të Rajonit të Tetë

Aktivitet i veçantë përbrenda Bordit Rregullativ të Komunitetit të Energjisë, Operatorëve të Transmisionit të Evropës Juglindore dhe Grupit Punues për Energji, si dhe Grupit Implementues

është kurorëzuar me përgatitjen e Memorandumit të Mirëkuptimit për Zyrën Rajonale të Auksionit për shtetet anëtare të Rajonit të 8^{të}. Memorandumi i Mirëkuptimit është nënshkruar më 11 nëntor 2008 në Tiranë, nga përfaqësuesit e operatorëve të Sistemeve Transmetuese të shteteve të rajonit. Është vendosur që selia e zyrës së auksionit të jetë Mali i Zi, përkatësisht Podgorica.

Më 28 nëntor të 2008 janë nënshkruar kontratat ndaras me dy kompani këshillëdhënëse, që do të studiojnë rrethanat rreth vendosjes së zyrës së auksionit të koordinuar, si dhe finalizimin e skemës së auksionit të koordinuar për kapacitetet ndërkufitare.

Zyra e Rregullatorit të Energjisë ka bashkëpunuar me Sekretariatit të TKE, duke plotësuar shumë pyetësorë dhe ka kontribuar në azhurnimin e Raportit Nacional për vitin 2008, që publikohet nga vetë sekretariati.

Grupi Implementues i EJL për Zyrën e Auksionit të Koordinuar

Ky grup është i formuar nga përfaqësuesit e Operatorëve të Transmisioneve Rajonale dhe përfaqësuesve të rregullatorëve rajonalë. Gjatë vitit 2008 grupi është marrë kryesisht rreth aktiviteteve dhe rezultateve nga SETSO, implementimi i planit të veprimit, menaxhimi i mbingarkimit në linjat interkonektive, memorandumit i mirëkuptimit MoU për ZAK, etj.

Forumi i Athinës, në kuadër të TKE të EJL

ZRRE-ja ka marrë pjesë në takimet e Forumit të Athinës: të 12-in me radhë, të mbajtur më 15-16 maj 2008 dhe të 13-in, të mbajtur më 2-3 dhjetor 2008. Të dy takimet janë mbajtur në Athinë dhe disa nga përfundimet nga këto takime mund të përmbledhin si vijon:

- **Takimi i 12-të:** Forumi ka qenë i udhëhequr nga presidenca aktuale e Komunitetit të Energjisë, përkatësisht përfaqësuesit të qeverisë së Kosovës (UNMIK). Në takim, përveç të tjerave, u prezantua statusi aktual i zbatimit të Direktivës së Unionit Evropian për energji elektrike 2003/54/EC dhe Rregullës EC NO 1288/2003. Forumi inkurajoi palët nënshkruese të KTE të EJL që të shtojë aktivitetet që të përballojë sfidat që dalin nga zbatimi i dokumenteve që dalin nga TKE të EJL.
- **Takimi i 13-të:** Vlen të përmendet se në këtë takim iu dha përkrahje e plotë proceseve dhe aktiviteteve rreth formimit të Zyrës së Koordinuar të Auksionit.

Forumi social i TKE të EJL: ZRRE-ja ka marrë pjesë aktive në forumin social të organizuar në Vjenë, në maj, dhe në Tiranë më 18-19 nëntor 2008.

Asociacioni i rregullatorëve rajonalë për energji ARrRE-ja (ERRA)

Asociacioni i rregullatorëve rajonalë për energji bashkon rregullatorët e pavarur energjetikë nacionalë të Evropës Qendrore, Lindore dhe numrit më të madh të shteteve ballkanike. Ky asociacion ka gjithsej 22 anëtarë të rregullt dhe katër anëtarë shoqëruar. Kosova është anëtare shoqëruar. Asociacioni i Rregullatorëve Nacionalë të SHBA gjithashtu është anëtar i bashkangjitur i këtij asociacioni. Asociacioni (ERRA) ka katër grupe punuese: atë të licencimit, të tarifave, të rregullimit ligjor dhe të integriteteve evropiane. ZRRE-ja përfaqësohet në të gjitha këto grupe punuese të këtij asociacioni.

Synimet themelore të ARrRE janë si në vijim: të përmirësojë legjislacionet nacionale në shtetet anëtare; të nxisë zhvillimet për një rregullator të energjisë autonom dhe autoritativ, si dhe të nxisë bashkëpunim ndërmjet vetë rregullatorëve; të rrisë komunikimin dhe shkëmbimin e informatave, si dhe të bëjë të mundshme qasjen në to si dhe shkëmbim të përvojave të rregullatorëve të ndryshëm në botë;

të promovojë dhe mundësoj trajnime.

ARrRE-ja rregullisht organizon konferencën vjetore, e cila në vitin 2008 u zhvillua në Hungari. ZRRE-ja ka marrë pjesë në këtë takim duke i ndjekur sesionet e veçanta të Komitetit të Tarifave dhe Çmimeve, në sesionin e kryetarëve të rregullatorëve të shteteve anëtare të asociacionit.

ZRRE-ja ka marrë pjesë aktive në të gjitha takimet e grupeve punuese të ARrRE, si në Grupin për Tarifa dhe Çmime, Grupin për Licenca, Grupin Legal etj.

Në nëntor 2008, pjesëmarrje në trajnimin e organizuar nga ERRA në Budapest lidhur me rregullimin e ngrohjes dhe gazit. Qëllimi i këtij trajnimi ishte prezantimi i gjendjes aktuale të furnizimit dhe distribuimit me gaz duke u çmuar si një ndër derivatet me të pastra dhe më ekonomike;

ZRRE-ja ka bashkëpunuar vazhdimisht me ARrRE-n duke u përgjigjur në pyetësorë të ndryshëm nga sektori i energjisë.

Partneriteti ndërmjet Zyrës së Rregullatorit të Energjisë dhe Komisionit Ekonomik të shtetit Illinois, SHBA

Më 28 tetor të vitit 2008 ZRRE-ja ka nënshkruar Memorandumin për lidhjen e Partneritetit me Agjencinë Rregullative të Illinois-it të SHBA. Objekt i partneritetit ndërmjet dy agjencive rregullative do të jetë shkëmbimi i përvojave dhe informatave ndërmjet veti, me synim të përmirësimit të praktikave me të mira në baza të tregut, duke forcuar lidhjet ndërmjet dy agjencive.

Ky partneritet do t'i mundësojë stafit të ZRRE-së të ketë qasje dhe të kuptojë praktikat rregullative në SHBA dhe, në anën tjetër, ICC do të ketë mundësi të mësojë teknika dhe metodologji të reja në fushën rregullative, si dhe të kuptojë më mirë praktikat e tilla në Evropën Juglindore.

Partneriteti mbështetet financiarisht nga USAID, ndërsa aktivitetet udhëhiqen nga NARUC-u dhe do të zgjasin nga tetori i 2008 deri në shtator të 2010. Partneriteti parasheh shkëmbime, punëtori teknike-seminare, internshipe, trajnime dhe zhvillim institucional të ZRRE-së. Në tetor të vitit 2008 u bë vizita e parë e ICC në Prishtinë dhe në këtë rast u nënshkrua Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet dy institucioneve.



Fig.6.4 Pamje nga ceremonia e nënshkrimit të Memorandumit të Mirëkuptimit.: Patricia Rader, drejtore e Misionit të USAID për Kosovë, Dr. Ali Hamiti, kryetar i bordit të ZRRE-së dhe Charls Box, kryetar i bordit të komisionarëve të ICC.

Ceremonia e nënshkrimit u përshëndet nga Jakup Krasniqi, kryetari i Parlamentit të Kosovës, Justina Pula-Shiroka, ministre e Energjisë dhe Minierave, Patricia Rader, drejtoare e Misionit të USAID-it për Kosovë, si dhe përfaqësues të NARUC-ut.

Gjatë vizitës së parë katërditore të ICC u shkëmbyen përvoja dhe u shtruan tema për diskutim si participimi i publikut në vendimmarrje të agjencive rregullative, përvojat në SHBA dhe Kosovë për mbrojtjen e konsumatorëve, tregu nacional dhe rajonal i energjisë elektrike, tarifave, kualiteti i furnizimit dhe ristrukturimi i sektorit të energjisë elektrike. Gjithashtu, si pjesë e aktivitetit njëjavor të partneritetit ka qenë punëtorja njëditore me temë “Gjendja e sektorit të energjisë në Kosovë”, në të cilën kanë marrë pjesë përfaqësuesit e të gjitha palëve të kyçura në sektorin e energjisë në Kosovë: Komisioni Parlamentar për Energji, Ministria për Energji dhe Miniera, Korporata Energjetike e Kosovës, Operatori i Sistemit të Transmisionit, KOSTT si dhe përfaqësuesit e mediave. Në fund të kësaj vizite delegacioni i ICC ka vizituar minierat dhe termocentralet e KEK-ut.

Aktivite të tjera

Bashkorganizuar nga Asociacioni Kombëtar i Rregullatorëve për Ndërmarrjet e Shërbimeve Publike i SHBA (National Association of Regulatory Utility Commissioners - NARUC), Asociacioni Rajonal i Rregullatorëve të Energjisë (Energy Regulators Regional Association - ERRA) dhe Qendra për Energji dhe Burime Natyrore të Universitetin Amerikanë të Kosovës (AUK), me përkrahje të USAID/Kosovë, është mbajtur një punëtori treditore mbi “**Rregullimin e Kompanive të Shërbimeve Publike në Ekonomitë e Tregut**” prej 14-16 prill 2008 në AUK, Prishtinë. Në punëtori kanë marrë pjesë përfaqësues nga: Qeveria e Kosovës, Ministria për Energji dhe Miniera, deputetë të Kuvendit të Kosovës, Zyra e Rregullatorit për Energji, industria e shërbimeve publike (KEK-u dhe KOSTT-i); komuniteti i mediave; shoqëritë e konsumatorëve dhe shoqëria civile.

Temat e trajtuara në punëtori kanë qenë: parimet themelore të rregullimit ekonomik dhe të energjisë; rëndësia dhe qasjet e sigurimit të autonomisë funksionale dhe fiskale për agjencitë rregullative; përkufizimi i roleve dhe përgjegjësi të bartësve në procesin rregullativ; qasjet specifike për sektorin e energjisë, raste studimi, metodologjitë dhe mënyra e aplikimit të tyre. Ligjëruesit në këtë punëtori kanë qenë autoritete të njohura të lëmisë rregullative nga Lituania, Hungaria, SHBA dhe Kosova.

Gjatë kësaj punëtorie janë prezantuar dhe diskutuar edhe tema konkrete që i referohen sektorit të energjisë në Kosovë si: Reforma e Sektorit të Energjisë, Hyrje në Rregullimin e Kompanive të Shërbimeve Publike; Roli i Rregullimit në Adresimin e Sfidave të Sektorit të Energjisë në Kosovë; Autonomia Fiskale dhe Mbikëqyrja e Buxhetit për Agjencitë Rregullative.

Në shtator 2008 Departamenti për Tarifa dhe Çmime ka prezantuar “Zhvillimet në Përcaktimin e Tarifave që Pasqyrojnë Kostot” në takim sektorial dhe infrastrukturor të organizuar nga Komisioni Evropian. Në këtë takim u prezantua qasja e ZRRE-së ndaj përcaktimit të tarifave dhe faktorëve që kanë ndikim të konsiderueshëm në përcaktimin e tyre. Në takim morën pjesë, përveç përfaqësuesve të KE dhe ZRRE-së, edhe përfaqësues të qeverisë dhe të ndërmarrjeve të licencuara.

Adresa:

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGI

Rr. Hamdi Mramori nr. 1, 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: 038 247 615 lok. 101, Fax: 038 247 620,

E-mail: info@ero-ks.org, web: www.ero-ks.org